



Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit e konsumatorëve në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator



STUDIM mbi

Situatën aktuale të klientëve në nevojë në lidhje me furnizimin me energji elektrike dhe efektet sociale e ekonomike të mungesës apo kufizimeve në marrjen e këtij shërbimi.

Tiranë 2021



Ky studim u mundësua në kontekstin e Projektit: *“Mbështetje për forcimin e kapaciteteve institucionale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) në zbatimin e mandatit të tij për të mbrojtur nga diskriminimi gratë dhe burrat në Shqipëri”*, zbatuar nga KMD në bashkëpunim me UNDP me fonde të qeverisë Norvegjeze.

PËRMBAJTJA

1.Hyrje	3
2.Metodologjia	5
3.Komponenti ligjor - Analiza e Gjetjeve	7
3.1Standardi sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut	7
3.2Standardi në kuadër të këshillit të europës.	9
3.3Standardi në kuadër të Bashkimit Europian	9
3.4Zbatimi i parimit të mosdiskriminimit	9
3.5Rregullimi sipas legjislacionit shqiptar për “klientin në nevojë”	10
3.6Praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi	17
4.Komponenti social - Analiza e Gjetjeve	20
4.1Profili i individëve pjesëmarrës në studim	20
4.2Aksesi në shërbimin e energjisë elektrike dhe efektet sociale si pasojë e mungesës apo kufizimit në përdorimin e energjisë.	23
4.3Marrëdhënia me institucionet dhe shkalla e informimit.	30
5.Komponenti ekonomik – Analiza e Gjetjeve	34
5.1Koncepti i varfërisë energjitike dhe standartet europiane	34
5.2Metoda	38
5.3Të dhënat dhe analiza	41
5.4Modelet e shpenzimeve të energjisë – Konsumi	4
6.Konkluzione dhe Rekomandime	52
Referenca	57
Aneks	5938

1. Hyrje

Ky është një studim i realizuar nga organizatat jofitimprurëse Qendra “T’REJA”, Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome”, Qendra “Për Advokim Social”, Qendra “Aksion Komunitar”, Qendra “Konsumatori Shqiptar” dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe UNDP Albania. Qëllimi i këtij studimi është eksplorimi dhe ekzaminimi i marrëdhënies së shtresave më të pamundura të shoqërisë (apo siç do të kategorizohet ndryshe në rolin e konsumatorit si klienti në nevojë), me një shërbim jetik si energjia elektrike. Përmes këtij studimi synohet të matet si aftësia paguese e konsumatorit në nevojë ashtu edhe impakti social dhe ekonomik që prodhon mungesa e energjisë elektrike apo pamundësia për ta përfituar këtë shërbim. Të dhënat dhe analiza që do të gjenerohen nga ky studim mendohet t’i shërbejnë institucioneve publike si: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe institucioneve të tjera, si dhe organizatave jofitimprurëse të përfshira në këtë nismë dhe tjera të interesuara bashkë me publikun, për një njohje më të thelluar të problemit, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e përshtatshme, në përputhje me nevojat reale të këtyre grupeve shoqërore të shoqërisë shqiptare.

Synimi kryesor mbetet ndarja e këtyre gjetjeve me institucionet e ngarkuara nga Ligji Nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë”, i ndryshuar, që të nxiten në përmbushjen e detyrimit të tyre kushtetues dhe ligjor në miratimin e aktit të nevojshëm për rregullimin e konsumatorit të “klientit në nevojë”. Studimi është ideuar si reflektim i tre aspekteve kryesore ndikuese në statusin e “klientit në nevojë”, dhe më konkretisht të aspektit ligjor, aspektit social dhe atij ekonomik. Analiza ligjore parashton njohjen e të drejtës nëpërmjet ligjit, mosgarantimin e saj dhe mosmaterializimin për shkak të mosnxjerrjes së aktit nënligjor të nevojshëm. Aspekti social pasqyron grupe

shoqërore të prekura nga mosmiratimi i aktit nënligjor duke reflektuar mbi thellimin e pamundësisë së tyre. Aspekti ekonomik synon të japë një pamje mbi koston ekonomike të energjisë elektrike në familjet e grupeve shoqërore të sipërpërmendura, duke i kategorizuar ata në bazë të të ardhurave me qëllim evidentimin e varfërisë energjitike.

Në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i politikave dhe instrumenteve të duhur, matja e varfërisë energjetike është e rëndësishme për të kuptuar shkallën dhe thellësinë e problemit në nivelin kombëtar. Përzgjedhja e treguesve dhe qasjeve të përshtatshme për aplikim ose zhvillim janë faktorë që ende shfaqen në shumë debate, si dhe mund të shihen në analizën vijuese. Për shkak të rëndësisë që ka në këtë studim koncepti i varfërisë energjitike, sipas standarteve evropiane, aspekti ekonomik i familjeve të përfshira në studim, impakti ekonomik i energjisë në këto familje, komponentit ekonomik i është dedikuar një kapitull i veçantë duke u analizuar në mënyrë të detajuar. Qëllimi i kësaj analize ekonomike, përveç të tjerash, është të përcaktohet struktura e konsumit familjar të energjisë elektrike, që do të thotë se sa energji elektrike konsumohet nga çdo familje, për çdo shërbim të ofruar nga energjia elektrike në familje.

Projekti vlerësoi ndikimin dhe njohjen publike të varfërisë energjetike në qytetet pjesëmarrëse, si dhe hulumtoi strategjitë dhe mekanizmat financiarë për të mbështetur familjet në varfëri energjetike. Ndërsa kushtet ndryshojnë midis qyteteve, ka faktorë socio-ekonomikë që bëjnë që disa familje të jenë më të rrezikuara nga varfëria energjetike nëpër qytete të ndryshme dhe këto përfshijnë: të ardhura të ulëta (veçanërisht ato që nuk kualifikohen për ndihmë shtesë financiare), të papunë, pensionistë, të moshuarit, familje me fëmijë të mitur, familje me një prind, familje që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi

të kufizuara ose persona me sëmundje kronike, persona që jetojnë vetëm, nivel më i ulët arsimor, familje të pakicave kombëtare, kryesisht rome dhe egjiptiane, të rritur beqarë me të ardhura të ulëta, familje që jetojnë në shtëpi me energji joeficiente.

Një nga elementet e rëndësishëm të studimit për përcaktimin e kërkesave minimale për energji elektrike të familjeve në nevojë është pa dyshim analiza dhe marrja në konsideratë e politikave dhe strategjive qeveritare për mbështetjen e kategorive të familjeve në nevojë, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të përballojnë financiarisht pagesën e faturës së energjisë elektrike.

2. Metodologjia

Si bazë mbështetëse fillestare për kategorizimin e konsumatorit të “klientit në nevojë” janë marrë familjet e kategorizuara në VKM nr. 565/2006, VKM nr. 404/2012 dhe VKM nr. 8/2015. Aktualisht këto janë të vetmet akte që parashikojnë kompensim të energjisë elektrike për disa kategori familjesh të cilësuar si në nevojë.

Sipas autoriteteve publike numri i përfituesve është rreth 200.000 familje. Referuar këtyre Vendimeve si grupe përfituese janë të përfshira: familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, familjet me Kryefamiljar me aftësi të kufizuara, të verbër, paraplegjikë, tetraplegjikë, Kryefamiljarët pensionistë në qytet dhe fshat dhe punonjësit buxhetorë me pagë nën 35 mijë lekë në muaj. Këto janë grupimet shoqërore që kanë shërbyer si bazë për studimin, por në funksion të një analize më përfshirëse janë marrë parasysht edhe grupe të tjera shoqërore të cilat nuk përfitojnë kompensim për shkak se nuk kategorizohen në asnjërën nga kategoritë e tre VKM-ve të mësipërme.

Një pyetësor u krijua për të mbuluar vlerësimin socio-ekonomik të grupeve të synuara. Instrumenti i përdorur në mbledhjen e të dhënave sasiore ishte anketa në të cilën u integruan pyetje të mbyllura me pyetje gjysmë të hapura (shiko Aneksin në fund të studimit).

Pyetësori përbëhej nga 44 pyetje të përgjithshme. Ai ndërthuri pyetje të hapura dhe pyetje

me zgjedhje të shumëfishta me përgjigje të paracaktuara duke u ofruar të anketuarve mundësinë për të zgjedhur dhe renditur në mes të disa opsioneve ose mundësinë për të vlerësuar në një shkallë “shumë të ulët” në “shumë të lartë”. Për këto pyetje, u dha një hapësirë opsionale për të elaboruar përgjigjen. Kjo pjesë e hapur konsiderohet e një rëndësie të madhe për një studim të këtij lloji pasi kontribuon në përmirësimin e interpretimit të rezultateve të tij të përgjithshme dhe ofron informacione të vlefshme shtesë për autoritetet.

Pyetësori përdori një teknikë të marrjes së mostrave për shkak të madhësisë së vogël të popullsisë dhe mblodhi informacion mbi gjendjen social-ekonomike të grupeve të intervistuar, si dhe mbi praktikën e energjisë duke u përqendruar në llojet e karburanteve të gatimit dhe pajisjeve, si dhe kostot e energjisë elektrike të përdorur çdo muaj për nevojat themelore si: gatimi, ngrohja dhe ndriçimi.

Instrumenti i fundit i pyetësorit përbëhej nga pyetje që lidhen me llojet e energjisë dhe sobave të familjeve, kostot e energjisë dhe praktikën e konsumit dhe faktorët që ndikojnë në zgjedhjet e burimit (karburantit) të shtëpive.

Mjetet që u përdorën në terren për realizimin e pyetësorit ishin tabletat dhe celularët të pajisur me aplikacionin google forms, përmes të cilit gjenerohen automatikisht të dhënat në databazën përkatëse.

Të dhënat u mblodhën përmes intervistave ballë për ballë, gjatë periudhës shtator-tetor 2020. U bënë përpjekje të konsiderueshme për të mbledhur informacion nga të gjitha familjet që u zgjodhën nga ky studim. Informacioni i mbledhur ishte i dobishëm për të ndjekur këto familje dhe për të analizuar situatën e këtyre familjeve në kuadër të situatës së varfërisë energjetike.

Studimi u bazua në metodën e kombinuar sasiore-cilësore të mbledhjes së të dhënave.

Kampioni i studimit, përbëhet nga rreth 1005 raste që përfaqësojnë 4,713 anëtarë familjesh. Për shtrirjen gjeografike të studimit jemi mbështetur në dy kritere. Kriteri i parë buronte dhe njëkohësisht kushtëzohej prej zonave në të cilat operojnë organizatat e përfshira në këtë projekt.

Më konkretisht, duke qenë se për implementimin në terren të studimit u angazhuan si intervistues anëtarët e organizatave u vlerësua si e nevojshme që studimi të shtrihej në zonat që njihen më mirë nga organizatat dhe ku disponohen më shumë burime njerëzore. Në përcaktimin e kriterit të dytë u vlerësua domosdoshmëria e përfshirjes së zonave urbane në të gjithë Shqipërinë (Jug, Veri dhe Shqipërinë e mesme) me qëllimin e ndërtimit të një harte përfaqësuese të njësive të studiuara. Bashkitë ku u zhvillua studimi janë: Tiranë, Elbasan, Durrës, Korçë, Pogradec, Berat, Fier dhe Shkodër. Gjithashtu u identifikuan lagjet me numrin apo peshën më të madhe në përqindje të banorëve që bëjnë pjesë në këtë shtresë sociale, si zona në të cilat do të aplikohet anketimi. Metoda që u aplikua në terren në zonat e paracaktuara sipas kriterëve të lartpërmendura ishte kampionimi *random*, përmes teknikës së përzgjedhjes rastësore të subjektit që do të intervistohet.

Në rrafshin cilësor të studimit u operua përmes fokus-grupeve dhe intervistave të thelluara. U realizuan 16 fokus grupe, në një ndarje në dy fokus-grupe për çdo bashki. Në secilin prej fokus-grupeve morën pjesë 8 individë të ndarë sipas gjinisë. U konceptua ndarja në dy grupe në bazë të gjinisë me qëllimin që të ekzaminohej edhe perspektiva gjinore në marrëdhënie me impaktin social dhe ekonomik të mungesës së energjisë elektrike në familjet respektive. Për fokus-grupet u ndërtua një guidë pyetjesh që kishte për synim të eksploronte më thellë variablat e trajtuar edhe përmes anketave ashtu si edhe elementë të tjerë që nuk mund të rrokeshin plotësisht përmes instrumentit sasior të mbledhjes së të dhënave.

3. Komponenti ligjor

3.1 Standardi sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

E drejta për strehim të përshtatshëm është një e drejtë e njeriut e njohur në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut si pjesë e së drejtës për një standard të përshtatshëm të jetesës. Një nga referencat e para për të është në nenin 25 (1) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i konsideruar gjerësisht si instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtës për strehim të përshtatshëm, i referohet të drejtës së secilit për një standard të duhur jetese për vete dhe familjen e tij, përfshirë ushqimin, veshjen e përshtatshme dhe strehimin, dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës (neni 11).

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka theksuar se e drejta për strehim të përshtatshëm nuk duhet të interpretohet ngushtë. Përkundrazi, duhet parë si një e drejtë për të jetuar në siguri, paqe dhe dinjitet. Karakteristikat e së drejtës për strehim të përshtatshëm sqarohen kryesisht në Komentin e Përgjithshëm nr. 4 (1991) mbi të drejtën për strehim adekuat dhe nr. 7 (1997) mbi dëbimet e detyrueshme, të këtij komiteti.

Strehimi i përshtatshëm duhet të sigurojë më shumë se katër mure dhe një çati. Duhet të plotësohen një numër kushtesh të veçanta të strehimit, që të mund të flasim për “strehim të përshtatshëm”. Që strehimi të jetë i përshtatshëm, ai duhet, së paku, të plotësojë ndër të tjera kriterin në lidhje me: “*Disponueshmërinë e shërbimeve, materialeve, pajisjeve dhe infrastrukturës*”. **Sipas këtij kriteri, strehimi nuk është i përshtatshëm nëse banorët e tij nuk kanë ujë të pijshëm të sigurt, kanalizime të përshtatshme, energji për gatim, ngrohje, ndriçim, ruajtjen e ushqimit ose hedhjen e mbeturinave.**

Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura, të pandashme dhe të ndërlidhura. Me fjalë të tjera, shkelja e të drejtës për strehim të përshtatshëm mund të ndikojë në gëzimin e shumë të drejtave të tjera të njeriut dhe anasjelltas. Qasja në strehim të përshtatshëm mund të jetë parakusht për gëzimin e disa të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për punë, shëndetësi, arsim, sigurime shoqërore, të drejtën për të votuar dhe atë për jetën private dhe familjare.

Energjia elektrike është një komponent kryesor dhe thelbësor i strehimit të përshtatshëm, prandaj të jetosh në ditët e sotme pa energji elektrike e bën jetën e secilit të vështirë ose ekstremisht të pamundur. Qasja ndaj energjisë elektrike është një parakusht i pashmangshëm për një strehim të përshtatshëm dhe njëkohësisht është thelbësor

për garantimin e të drejtave të tjera, duke siguruar gjithashtu uljen e varfërisë. Mungesa e qasjes ndaj energjisë elektrike është njëkohësisht pasojë e varfërisë, por edhe një nga shkaktarët e saj. Sa më sipër e drejta për të patur energji elektrike është padyshim një e drejtë themelore e njeriut.

Si një e drejtë themelore e njeriut, Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në energji elektrike e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e një strehimi të papërshtatshëm.

Rëndësia e të drejtës për të patur energji elektrike rezulton qartë edhe nga fakti se ajo përbën një nga Objektivat Botërorë për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe konkretisht *Objektivi 7: Sigurimi i aksesit në energji me kosto të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë*. Kjo do të thotë se pa qasje në energji elektrike nuk ka zhvillim, e aq më pak garanci për mundësi të barabarta e gjithëpërfshirje.

3.2 Standarti në kuadër të Këshillit të Evropës

Në kuadër të Këshillit të Evropës, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Karta Sociale Europiane nuk i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtës për strehim të përshtatshëm, por në jurisprudencën e GJEDNJ, mbrojtja e saj ka ardhur si rezultat i gëzimit të të drejtave të tjera të njeriut, siç janë e drejta për jetën private, e drejta e pronës dhe gëzimi paqësor i pasurisë dhe e drejta e mbrojtjes së familjes.

Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut në rastin *Pocasovski and Mihaila v. the Republic Of Moldova and Russia* (kërkesa nr. 1089/09) ka vendosur që mungesa e energjisë elektrike është shkelje e të drejtave të njeriut pikërisht të nenit 3 dhe 8, askush nuk mund t'i nënshtrohet trajtimit degradues dhe çnjerëzor si dhe e drejta për jetë private dhe familjare. Në këtë çështje gjykata arriti në përfundimin se, burrat e ndaluar në burg pa ujë, energji dhe ngrohje ishin mbajtur në kushte çnjerëzore.

3.3 Standardi në kuadër të Bashkimit Evropian

Në *Direktivën 2009/72/EC*, të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike, në nenin 7, parashikohet se:

“Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët dhe do të sigurojnë marrjen e masave adekuate mbrojtëse për të mbrojtur konsumatorët e cenueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të definojë konceptin e konsumatorëve të cenueshëm, i cili do t'i referohet varfërisë dhe midis të tjerave duhet të ndalojë ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët në raste kritike”.

Në nenin 8, të kësaj Direktive, parashikohet se:

“Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate sikundër janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, që sjell përfitime në sistemin e sigurimit social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cenueshëm apo ofrimin e përkrahjes për përmirësimin e efikasitetit të energjisë”.

3.4 Zbatimi i parimit të mosdiskriminimit

Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Mosdiskriminimi dhe barazia janë parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe elementë vendimtarë të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Parimi i mosdiskriminimit kërkon jo vetëm trajtimin e barabartë situatave të njëjta/ ngjashme por edhe trajtimin e ndryshëm të situatave të ndryshme. Diskriminimi është i lidhur me marginalizimin e grupeve të pamundura të popullsisë dhe është përgjithësisht në rrënjën e pabarazive strukturore brenda shoqërive.

Mbivendosja dhe ndërveprimi i disa shkaqeve

diskriminuere, për shembull, në bazë të gjinisë dhe racës, përkatësisë etnike ose aftësisë së kufizuar, gjendjes ekonomike apo gjendjes shoqërore, i vendos personat me të ardhura të ulëta, në situatë me pasoja akoma më të rënda. Për rrjedhojë, diskriminimi i shumëfishtë duhet gjithmonë të adresohet dhe të mbahet në vëmendje, pasi vetëm në këtë mënyrë adresojmë dhe sigurojmë në mënyrë efektive mbrojtjen nga diskriminimi dhe njëkohësisht krijojmë premisa për zhbërjen e diskriminimit të strukturuar në shoqëri.

3.5 Rregullimi sipas legjislacionit shqiptar për “klientin në nevojë”

Kushtetuta e Shqipërisë nuk e parashikon të drejtën për strehim në katalogun e të drejtave por në nenin 59 të saj nën rubrikën “Objektivat socialë”, duke parashikuar që Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon “plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim”, si dhe “standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm”. Gjithashtu, po e njëjta dispozitë parashikon që “Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave”.

Në këtë kuptim, objektivat socialë për t’u realizuar kanë nevojë për miratimin e ligjeve të posaçme, të cilat në parashikimet e tyre njohin njëkohësisht edhe të drejta që bëhen të detyrueshme për zbatim. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i cili ka përkufizuar konceptin “strehim i përshtatshëm”, që duhet të garantojë jetën private, një jetesë të sigurtë, të qetë dhe me dinjitet. Si një nga kushtet thelbësore sipas këtij ligji për një strehim të përshtatshëm është qasja “në shërbimet publike, si: furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve”.

Në vitin 2015, Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave miratoi Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”¹⁾, i ndryshuar, që për herë të parë parashikon rregullimin e kësaj

situatë me një term që quhet “klienti në nevojë”²⁾. Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike”.

Sipas Ligjit, me këtë term kuptohet “çdo klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruar në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji”. Ligji parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave për të disponuar me vendimmarrje lidhur me mënyrat, kriteret dhe procedurat sesi kategoritë që përfshihen në klientin në nevojë, do të marrin këtë përfitim.

Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” e ka rregulluar këtë marrëdhënie në nenet përkatëse 95 e 96 të tij. Sipas parashikimeve të nenit 95, Ministria përgjegjëse për të hartuar kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Ligji vendos detyrimin që hartimi i këtyre kriterëve dhe procedurave, nga ana e kësaj ministrie duhet të bëhen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Ministrinë e Financave, si dhe në konsultim me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) dhe grupet e interesit.

Kriteret thelbësore për të përfituar këtë status përcaktohen nga ligji, ku një ndër to, është ai i të ardhurave të ulta të klientëve që mund të përfitojnë. Por, për të materializuar të drejtën që ligji ka garantuar për personat me të ardhura të ulta, pra për ata që ligji i emërton “klientë në nevojë”, ligji ka parashikuar nxjerrjen e një akti nënligjor, i cili do të përcaktojë modalitetet dhe

2) Ky ligj është përafuar plotësisht me direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, e cila shfuqizon direktivën 2003/54/KE”, numri CELEX: 32009L0072, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 211, datë 14.8. 2009, faqe 55 - 93. Në këtë kuptim, klienti në nevojë i përshtatet konceptit të konsumatorit të cenueshëm sipas direktivës.

1) Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” ka pësuar ndryshime me ligjin nr. nr. 7/2018, datë 15.2.2018, ndryshime këto të cilat nuk prekin parashikimet në lidhje me klientin në nevojë.

procedurat. Brenda datës 15.06.2016 duhet të ishte miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave cili do t'u mundësonte individëve dhe familjeve me të ardhura të ulta që të përfitonin nga kjo e drejtë ligjore. Kanë kaluar pothuajse 5 vjet nga miratimi i ligjit dhe ky akt ende nuk është miratuar.

Por, çfarë përfitojnë kategoritë në nevojë që janë përfitues dhe gëzojnë statusin e “klientit në nevojë”?

Përgjigjen e kësaj pyetje e gjejmë tek neni 96 i ligjit, në të cilin parashikohet se ***klientët familjarë, të cilët kanë përfituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95, të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit të furnizimit universal, sipas parashikimeve të këtij ligji.***

Ligji (neni 2, pika 76) e përkufizon ***“Shërbimin universal të furnizimit” si një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t'u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.*** Me Vendimin nr. 246, datë 11.12.2018 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë është miratuar Rregullorja ***“Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”.*** Si bazë ligjore për miratimin e saj kanë shërbyer nenet 95 dhe 96 të Ligjit nr. 43/2015, që rregullojnë situatën e klientit në nevojë. Bazuar në parashikimet e kësaj rregulloreje, Furnizuesi i Shërbimit Universal, ka një sërë detyrimesh, ku ndër të tjera:

- Furnizuesi duhet të vendosë sisteme/procese që sigurojnë se ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për klientët, të cilët gëzojnë statusin e “klientit në nevojë” dhe janë të regjistruar si të tillë, do të bëhet bazuar në kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për këtë kategori klientësh.
- Klientëve në nevojë nuk mund t'u ndërpritet furnizimi me energji për shkak të mos pagesës se faturave të energjisë elektrike.
- Furnizuesi i energjisë elektrike nuk mund të ndërpresë furnizimin për mospagesë kur një klient përfiton nga statusi i “klientit

në nevojë”, përveç se kur në 12 muajt e mëparshëm, ofruesi i shërbimit (furnizuesi), i ka ofruar dy herë një plan pagese që përshtatet me të ardhurat e klientit ose asistencë pagese, në kuadër të statusit si “klient në nevojë” dhe është refuzuar nga klienti në nevojë.

- Furnizimi me energji elektrike nuk mund të ndërpritet në rastet kur klienti, ka paraqitur dhe është në proces të trajtimit të kërkesës së tij, për t'u klasifikuar si “klient në nevojë”.
- Kur klienti ose një prej familjarëve të tij përdorin pajisje për mbështetjen e jetës të cilat funksionojnë me energji elektrike dhe ka njoftuar paraprakisht me shkrim për këtë situatë Furnizuesin Universal.
- Nuk mund të ndërpritet furnizimi me energji elektrike në ditët kur Furnizuesi nuk realizon shërbim për klientët në Qendrat e Kujdesit Ndaj Klientit (KNK), ose : a) Kur Klienti është duke respektuar një plan pagese formale. b) Kur Klienti ka paraqitur një ankesë, pranë KNK-ve ose zyrave të ERE-s, lidhur me shërbimin e furnizimit universal.
- Pavarësisht nga sa më lart, furnizimi i energjisë elektrike për klientët në nevojë, nuk mund të ndërpritet edhe në rastet e mëposhtme:
 - o Kur një Klient në nevojë i energjisë elektrike nuk paguan për furnizimin me energji elektrike plotësisht ose pjesërisht, sikurse kërkohet në kontratën e energjisë elektrike, por detyrimi i tij i përgjithshëm ndaj furnizuesit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nuk e tejkalon nivelin minimal të të ardhurave, ose
 - o Në fundjavë ose gjatë ditëve të pushimit, sikurse dhe në rastet e kushteve atmosferike me temperaturë ditore – 15 gradë celcius.

Me kërkesë të klientit në nevojë, Furnizuesi është i detyruar që të marrë masa për riaktivizimin e furnizimit me energji elektrike, brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës së detyrimit për energjinë elektrike. Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për klientët në nevojë, mund të bëhet vetëm në kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara nga Rregullorja e ERE-s.

Duhet shënuar që edhe pse është miratuar kjo Rregullore nga ERE, ajo mbetet e pazbatueshme pasi kërkon si parakusht miratimin e aktit

nënligjor nga ana e Këshillit të Ministrave për “*klientin në nevojë*”.

Para miratimit të Ligjit nr. 43/2015, Qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa masa për lehtësimin e kategorive të ndryshme në nevojë si: familjet me ndihmë ekonomike, kryefamiljarët me aftësi të kufizuara, pensionistët, invalidët dhe buxhetorët me pagë nën 35 000 lekë në muaj, të cilat përfitojnë kompensim të energjisë në zbatim të akteve të mëposhtme:

- VKM nr. 565 datë 09.08.2006 “*Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike*”, të ndryshuar;
- VKM nr. 404 datë 20.06.2012 “*Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, për personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse*”.
- VKM nr. 8 datë 14.01.2015 “*Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj*”.

Këto akte nënligjore parashikojnë mbështetje për kategoritë në nevojë, mbështetje kjo që është në formën e kompensimit financiar për energjinë elektrike. Është për t’u theksuar se, të gjitha këto akte nënligjore, janë akte që kanë dalë përpara hyrjes në fuqi të parashikimeve të Ligjit “*Për sektorin e energjisë elektrike*”.

Në momentin e miratimit të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, ato janë vlerësuar si të pamjaftueshme për të mbrojtur shtresat në nevojë, pasi ligji ka parashikuar masa të tjera mbrojtëse sipas neneve 95 e 96 të këtij ligji siç është *përfitimi i shërbimit të furnizimit universal*.

Nenet 95 dhe 96 të Ligjit nr. 43/2015 ofrojnë masa mbrojtëse sikurse është garantimi i të drejtës për t’u furnizuar me energji elektrike. Pra, edhe në kushtet e mospagesës së faturës së energjisë elektrike, personat që do të gëzojnë statusin e “*klientit në nevojë*”, nuk do t’u ndërpritet energjia elektrike. Masat mbrojtëse që ofrojnë aktet nënligjore, jo vetëm që janë të një natyre tjetër, nga mbrojtja që ofron përfitimi i “*shërbimit të furnizimit universal*”, nga ana e personave që mund të gëzonin statusin e “*klientit në nevojë*”,

por janë edhe të pamjaftueshme për të garantuar një mbrojtje efektive të shtresave në nevojë.

Pika 1, e nenit 95 të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” ka përcaktuar qartazi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është struktura përkatëse përgjegjëse për hartimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat më pas miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Pavarsisht këtij detyrimi ligjor, kjo Ministri nuk e ka përmbushur ende një detyrë të tillë.

Bazuar në nenin 95/1 të Ligjit nr. 43/2015, si dhe VKM nr. 508, datë 13.09.2017 “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*”, ku përcaktohet se MSHMS ndër të tjera është përgjegjëse për zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë, del qartë fusha e përgjegjësisë e MSHMS për hartimin e aktit nënligjor për “*klientin në nevojë*”. Në rastin konkret neni 95/1 i Ligjit nr. 43/2015 i referohet një rregullimi të posaçëm në sektorin e energjisë, por që ka si qëllim pikërisht mbrojtjen, integrimin dhe përmirësimin e mirëqenies sociale të individëve dhe familjeve në nevojë.

Ligji nr.43, datë 30.04.2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 28.05.2015 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare. Aktet nënligjore duhej të ishin miratuar nga Këshilli i Ministrave, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra brenda datës 15.06.2016.

Rendi juridik nuk është një radhitje e barazvlefshme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash duke përcaktuar kështu edhe fuqinë juridike përkatëse³⁾ Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike⁴⁾. Kushtetuta, si akti themelor i një shteti, parashikon organet dhe kushtet në të cilat duhet të nxirren

3) Hans Kelsen, Reine Rechtslehre (1960), fq. 228

4) Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 09.11.2005. Përmbledhje e vendimeve, viti 2005, fq.242

aktet normative, duke synuar qëndrueshmërinë e tyre.

Duke qenë se Kushtetuta është tërësi e normave të caktuara të vendosura nga ligjvënësi, cenimi i saj do të thotë kryerja e një veprimi apo mosveprimi që bie ndesh me këtë tërësi normash.

Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese. Megjithëse disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale por dhe njohjes së të drejtave për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra, Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore politike të një vendi, por vetëm të parimeve dhe kriterëve bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo.⁵⁾ Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore nga partitë politike ose qeveria. Gjithashtu, edhe ligjet, në të njëjtën mënyrë, përcaktojnë që për zbatimin dhe konkretizimin e të drejtave që parashikojnë të autorizojnë pushtetin ekzekutiv për nxjerrjen e akteve të nevojshme, në bazë të nenit 118 të Kushtetutës⁶⁾. Pra, materializimi i shumë të drejtave për qytetarët bëhet nëpërmjet miratimit të ligjeve nga Kuvendi dhe nxjerrjes së akteve nënligjore për implementimin dhe zbatimin e këtyre ligjeve nga ana e Qeverisë.

Sipas neneve 95 dhe 96 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” parashikohet se përfitimi i statusit të “klientit në nevojë” e për rrjedhojë edhe gëzimi i të drejtës për të përfituar shërbimin e furnizimit universal të energjisë elektrike, kushtëzohet nga miratimi i akteve nënligjore. Aktet nënligjore që do të

materializojnë të drejtën e individëve për të përfituar nga shërbimi i furnizimit universal, të garantuar nga Ligji nr. 43/2015 nuk janë miratuar, e për pasojë e drejta e garantuar nga ligji nuk mund të gëzohet efektivisht nga ana e individëve. Pra, duke mosvepruar nëpërmjet mosmiratimit të akteve nënligjore të urdhëruara nga ligji për t'u miratuar, institucionet përgjegjëse i kanë mohuar qytetarëve të drejtën për të përfituar nga një e drejtë që tashmë ju njihet me ligj.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (shih vendimet nr.2, datë 03.02.2010; nr.1, datë 12.01.2011; nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese)⁷⁾. Sa më sipër, bazuar në parimin e shtetit të së drejtës, organet e pushtetit publik kanë detyrimin që jo vetëm kur nxjerrin akte juridike, të ushtrojnë kompetencat e tyre në respektim të hierarkisë së akteve normative, por edhe që organet e pushtetit janë të detyruar të ushtrojnë kompetencat e tyre, sipas urdhërimeve të akteve normative që janë më lartë në hierarkinë e normave juridike. Mosushtrimi i kompetencave nga ana e organeve të pushtetit është në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe cenon qytetarët në gëzimin e të drejtave të tyre.

Mungesa e marrjes së masave për nxjerrjen e akteve nënligjore për hartimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave që nga data 15.06.2016, cenon rëndë jo vetëm përmbushjen e nevojave më minimale të një jetese normale të kësaj kategorie përfituesish, por edhe dinjitetin e tyre.

Kategoria e personave të cilët sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” mund të rezultojnë përfitues të statusit të “klientit në nevojë” janë vënë në pozita jo të

5) Konrad Hesse, Gruenzuege des Verfassungsrechts in BRD (1999), fq. 11

6) Neni 118, i Kushtetutës, sanksion : “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. 3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.”

7) Vendimi GJK nr. nr. 25 datë 28.04.2014

favorshme në përputhje me parashikimet e vetë këtij ligji; duke iu mohuar atyre mundësinë për të përfituar nga furnizimi me energji elektrike në periudha të caktuara gjatë të cilave gëzojnë statusin e klientit në nevojë apo dhe në rastet kur klienti ka paraqitur dhe është në proces të trajtimit të kërkesës së tij, për t'u klasifikuar si “*klient në nevojë*”. Pra, ata janë vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuuese, pikërisht për shkak të gjendjes së tyre sociale dhe të asaj ekonomike.

Thënë sa më sipër jemi në kushtet kur, është e qartë që nxjerrja e aktit nënligjor është detyrim i papërmbushur dhe se duke mosvepruar, pra duke mos e miratuar këtë akt nënligjor, grupet shoqërore në pamundësi ekonomike janë vendosur në kushte të pafavorshme duke iu cenuar e drejta për kushte të përshtatshme jetese të cilat cenon në thelb dinjitetin njerëzor.

3.6 Praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në ushtrim të kompetencave të tij, ka sjellë në vëmendje një problematikë të tillë ndër vite. Me vendimmarrje vijuese ka kërkuar nga autoritetet përgjegjëse të hartojnë aktin nënligjor përkatës, për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar.

Konkretisht, me vendimet nr. 92 dhe 97, datë 05.04.2018, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin për shkak të gjendjes sociale dhe ekonomike të shkaktuar si pasojë e mosnxjerrjes së aktit nënligjor në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015. Këto dy vendime janë bërë objekt i kontrollit gjyqësor nga gjykata administrative, e cila është shprehur se e vlerëson në përputhje me ligjin përfundimin e arritur nga KMD se mungesa e daljes së akteve nënligjore në zbatim të nenit 95 të Ligjit nr. 43/2015 ka cenuar jetesën dhe dinjitetin e ankuesve duke i vendosur në këtë mënyrë ata në pozita të disfavorshme pikërisht për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.⁸⁾

Gjatë procedurës administrative të realizuar nga Komisioneri, nga korrespondenca me Ministrinë

e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe e Energjisë dhe Entin Rregullator të Energjisë rezultoi se këta aktorë shprehën vullnetin e tyre për të bashkëpunuar në hartimin e aktit nënligjor, por që ata ishin në pritje të marrjes së nismës propozuese nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni përgjegjës përcaktuar nga neni 95/1 i Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar.

Ndërkohë KMD ka konstatuar edhe aspekte të tjera në lidhje me qasjen në energjinë elektrike. Konkretisht, me vendimet nr. 33 dhe 34, datë 07.04.2020, KMD ka konstatuar diskriminimin e tërthortë, për shkak të “gjendjes ekonomike”, të kategorisë së klientëve në nevojë, nga ana e Entit Rregullator të Energjisë (ERE). KMD kërkoi nga ERE marrjen e masave për ndryshimin e Rregullores “*Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes*”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që hyjnë në parashikimet ligjore të “klientit në nevojë”, të cilët ndodhen në pamundësi financiare për ta realizuar atë.

Rezulton se, për shkak të gjendjes ekonomike, personat vendosen në situatë diskriminuuese përballë pamundësisë për të siguruar furnizimin me energji elektrike, pasi lidhja e kontratës shoqërohet me kushtin për të paguar një shumë të konsiderueshme të hollash, e cila nuk mund të përballohet nga familjet e pamundura ekonomikisht. Kjo kategori ka si burim të vetëm jetese ndihmën ekonomike apo forma të tjera të mbështetjes shtetërore si: pagesa e aftësisë së kufizuar, përfitimin e pensioneve të ndryshme, apo edhe pagesa e papunësisë. Këto familje për shkak të pamundësisë ekonomike ose nuk kanë qasje në energjinë elektrike, ose e kanë të vështirë e shpesh të pamundur efektivisht qasjen në energji elektrike.

Në disa raste ka rezultuar se masat lehtësuese që autoritetet përgjegjëse kanë marrë për të gjithë klientët që furnizohen me energji elektrike, nuk kanë adresuar nevojat e veçanta që kategoritë në nevojë mund të kenë, duke sjellë si pasojë vendosjen në kushte të pafavorshme të tyre për të përfituar nga këto lehtësi.

Problematikat e konstatuara nga KMD tregojnë se autoritetet përgjegjëse në disa raste, edhe pse legjislacioni *de jure* ka marrë masa për të eliminuar

8) Vendimi nr. 4056, datë 08.11.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

situatat diskriminuere, në praktikë nëpërmjet mosveprimit i vendosin *de facto* personat në pozita diskriminuere. Në raste të tjera rezultojnë se autoritetet përgjegjëse nuk kanë qasjen e duhur ndaj nevojës për të zbatuar masa pozitive dhe për të trajtuar ndryshe raste të ndryshme në mënyrë që të shmangin situatat diskriminuere.

Bazuar në praktikën e KMD-së konstatohet se mungesa e furnizimit me energji elektrike prek në mënyrë disproporcionale pakicat romë dhe egjiptiane si një ndër grupimet më të varfra të popullsisë. Mungesa e energjisë elektrike gjithashtu prek në mënyrë të veçantë familjet që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuara ndryshe nga të verbrit, personat paraplegjikë dhe tetraplegjike, jo vetëm për shkak se ata dhe familjet e tyre gjithashtu janë ndër kategoritë më vulnerabël që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale, por edhe për faktin se mungesa e energjisë elektrike ndikon në përkeqësimin akoma edhe më tepër të gjendjes dhe shëndetit të tyre⁹⁾. Padyshim që në çdo familje pjesa më e prekur dhe e cenuar nga mungesa e energjisë elektrike janë fëmijët, si në lidhje me kujdesin fizik dhe shëndetin mendor të tyre, ashtu edhe për të drejtën për arsim, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara kuptuar sipas Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, gratë, vajzat, nënat e reja.

Në përfundim, me keqardhje konstatohet se:

- Mosmarrja e masave nga autoriteti përgjegjës që detyrohet nga Ligji për ndërmarrjen e nismës për nxjerrjen e aktit nënligjor;
- Mosbashkëpunimi midis institucioneve përgjegjëse për hartimin e aktit nënligjor;
- Mosnxjerrja e aktit nënligjor në kundërshtim me afatet ligjore,

vijojnë ende të shkaktojnë pasoja të rënda ndaj të drejtës për qasje në energjinë elektrike dhe garantimit të strehimit të përshtatshëm për familjet e pamundura, gjë që ka kontribuar në vështirësi serioze të përmbushjes së nevojave bazë të lidhura me ndriçimin, ngrohjen, higjienën,

qasjen në informacion, ruajtjen e shëndetit, arsimin, garantimin e jetës private, familjare etj.


4. Komponenti social - Analiza e Gjetjeve

4.1 Profili i individëve pjesëmarrës në studim.

Në anketim morën pjesë 1005 individë, nga të cilët 51.7% janë femra dhe 48.3% meshkuj. Shpërndarja gjeografike e anketimit në bazë të numrit të intervistuarve mbështetur në kriteret e paracaktuara, të diskutuara në seksionin mbi metodologjinë, pasqyrohet në Grafikon nr. 1, rreth 80.6% e të anketuarve janë midis moshës 19-60 vjeç.

Grafik 1.

Bashkia




Ndërtimi i profilit të grupit pjesëmarrës në anketim, të gjeneruara nga mbledhja e të dhënave të përgjithshme fiton një rëndësi të veçantë duke marrë parasysh fenomenin që eksplorohet në këtë studim. E shprehur ndryshe, në mënyrë që të deshifrohet marrëdhënia e këtij segmenti të varfër të shoqërisë me një shërbim të domosdoshëm si energjia elektrike është me rëndësi të kuptohen fillimisht karakteristikat e këtij formacioni shoqëror. Në këtë aspekt disa të dhëna që ekspozojnë disa prej tipareve të rëndësishme të këtij grupi shoqëror janë puna, burimi e niveli i të ardhurave; numri i anëtarëve të familjes, përkatësia etnike dhe niveli i arsimimit.

Kryesisht, përqindjama e madhe e të intervistuarve janë kryefamiljarë ose anëtarë të një familjeje të llojit bërthamë. Në terma më specifik, siç mund të vërehet edhe në Grafikon 2, rreth 60% e familjeve të të anketuarve përbëhet nga 4 deri në 7 anëtarë.

9) Shiko: Vendimin nr. 258, datë 20.12.2018, si dhe Vendimin nr. 115, datë 04.09.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Grafik 2.


Prej sa anëtarësh përbëhet familja juaj (me familje kuptohet një njësi ekonomike familjare, anëtarët e së cilës kanë kapital të përbashkët dhe ndajnë shpenzimet bashkë)?



Të lexuara, në marrëdhënien midis tyre, variabli i numrit të anëtarëve të familjes me variablin e të ardhurave mujore të familjes (shih grafikun 3) evidenton qartësisht nivelin e varfërisë së kësaj shtrese të shoqërisë. Mbështetur në pohimet e të intervistuarve, 56.5% e të cilëve deklarojnë se të ardhurat e tyre mujore janë pak se 20.000 lekë, 16.8% 25.000 lekë dhe vetëm 10% 30.000 lekë është lehtësisht e kuptueshme që kemi të bëjmë me familje që gjenden në kushtet e varfërisë dhe pamundësisë ekonomike. Nisur nga këto tregues, mund të theksohet prej fillimit të analizës (ky argument diskutohet më gjerësisht në sythin pasardhës) pamundësia e këtyre familjeve për të përfituar këtë shërbim mbështetur në të ardhurat e tyre dhe në mungesë të mbështetjes së nevojshme nga instanca të tjera jashtë familjes.

Grafik 3.

Sa janë të ardhurat mujore të familjes tuaj?



Kushtet e varfërisë ekstreme të të anketuarve shpjegohen gjithashtu me tipologjinë e punëve

dhe me burimet e mundshme të sigurimit të të ardhurave në përgjithësi. Po ashtu, të dhëna të tjera që ndihmojnë në ekzaminimin e profilit të kësaj shtrese të shoqërisë që paraqet vështirësi në


sigurimin e një shërbimi jetik si energjia elektrike janë niveli i arsimimit dhe përkatësia etnike. Shumica e të anketuarve, rreth 60% e tyre punojnë në punë informale, të paqëndrueshme dhe të keqpaguara. Ndërsa pjesa e mbetur e të anketuarve ndahen në tre kategori: 1) studentë dhe pensionistë; 2) familje që trajtohen me ndihmë ekonomike; 3) individë në pamundësi për të punuar, si pasojë e kushtëzimeve fiziologjike, që janë ose jo përfitues të mbështetjes si persona me aftësi të kufizuar.

Siç mund të shihet edhe në Grafikun 4, 42.3% e të anketuarve janë anëtarë të pakicës rome, 40.9% janë anëtarë të pakicës egjiptiane dhe vetëm 16% janë mazhorancë. Varfëria ekstreme e shumë prej familjeve dhe individëve nga këto dy pakica si dy prej formacioneve shoqërore nga më të margjinalizuarat në Shqipëri, është një fakt i njohur dhe i evidentuar në shumë raporte dhe studime.¹⁰⁾ Për rrjedhojë, është e vetëkuptueshme që këto dy pakica përbëjnë edhe dy prej segmenteve shoqërore më të prekura nga pamundësia për të paguar energjinë elektrike. Në këtë kontekst zë fill edhe arsyeja se përse këto dy pakica përbëjnë peshën më të madhe të kampionit të studimit tonë.

10) Shih psh. "Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: profili social-demografik dhe ekonomik, bazuar në censurin 2011". Përgatitur nga: Patrick Simon, me Emira Galanxhi dhe Olgeta Dhono. PNUD, Prill 2015


Grafik 4.

Përsa i përket përkatësisë suaj etnike, ju jeni?



Grafik 5.


A keni aktualisht energji elektrike në shtëpinë tuaj?



Niveli i arsimimit të të anketuarve përbën një tjetër indikator me vlerë në eksplorimin e profilit të popullatës së studimit. Mbështetur në të dhënat e gjeneruara nga studimi rezultojnë se 58% e të anketuarve kanë kryer më pak se 8 vite arsim. Ky është një prej faktorëve shpjegues, njëherazi të papunësisë ashtu edhe të tipologjive të punëve në të cilat angazhohen anëtarët e këtyre dy pakicave, duke vlerësuar që niveli i ulët arsimor redukton mundësitë e punësimit. Përpos mundësive aktuale të punësimit, niveli i ulët arsimor përbën një pengesë serioze që edhe në të ardhmen ky grup individësh të sigurojë burimet e nevojshme të të ardhurave për të tejkaluar varfërinë ekstreme. Në këto kushte bëhet i domosdoshëm stabilizimi i zgjidhjeve sistemike për mundësimin e shërbimit të energjisë elektrike dhe të gjitha shërbimeve jetike për sa një individ apo familje gjendet në kushtet e ekonomisë së mbijetesës dhe e ka të pamundur të dalë nga cikli i varfërisë.

Grafik 6.

Referuar tabelës më poshtë ju lutem na tregoni arsyet se përse nuk keni energji elektrike?



4.2 Akses i shërbimit të energjisë elektrike dhe efektet sociale si pasojë e mungesës apo kufizimit në përdorimin e energjisë.

Në momentin e zhvillimit të anketimit 18% e të intervistuarve (shih Grafikon 5) deklaruan që nuk kishin energji elektrike. 44.3% e atyre që deklarojnë se në momentin e zhvillimit të anketimit i është ndërprerë energjia elektrike në banesat e tyre, pohojnë si motiv të ndërprerjes pamundësinë për të paguar në tre muajt e fundit. Ndërsa, 41.2% pohojnë se i është ndërprerë energjia elektrike pasi nuk kanë mundësi të paguajnë këstin e radhës së debisë në bazë të aktmarrëveshjes me OSHEE-në (Grafiku 6).


Kur të anketuarit pyeten nëse i është ndërprerë ndonjëherë në të shkuarën energjia elektrike del në pah vulnerabiliteti i një shtrese të varfër e cila është vazhdimisht e ekspozuar ndaj pamundësisë për të marrë të tilla shërbime të domosdoshme. Siç pasqyrohet edhe në Grafikon 7, 73.5% e të anketuarve pohojnë që në të shkuarën i është ndërprerë energjia elektrike, duke dëshmuar kështu që gjasat janë të larta që të përballen me këtë gjendje në mënyrë të përsëritur. 29.8% e individëve pjesëmarrës në anketim pohojnë që ndërprerja ka zgjatur 1-2 muaj, 15.8% 3-4 muaj, dhe 31.2% 1-2 javë (shih Grafikon 8). Madje edhe gjatë periudhës së izolimit/karantinimit si pasojë e masave të vendosura nga qeveria prej

pandemisë së Covid-19, 47% e të anketuarve pohojnë që kanë patur probleme me mungesën e energjisë elektrike.

Këto të dhëna, nga njëra anë qartësojnë edhe më shumë mundësitë e qasjes të këtij shërbimi nga kjo shtresë e shoqërisë mbështetur në kapitalin e tyre familjar. Ndërsa nga ana tjetër, është me rëndësi të kuptohet se si anomalitë në marrjen e këtij shërbimi si ndërprerja për një kohë të konsiderueshme e energjisë elektrike, e afektojnë cilësinë e jetës së tyre, të ardhmen e fëmijëve apo se si e rëndojnë edhe më shumë barrën e të jetuarit në kushtet e mbijetesës.


Grafik 7.

A ju është ndërprerë ndonjëherë në të shkuarën energjia elektrike?



Grafik 8.


Sa është koha që jeni detyruar të qëndroni pa energji elektrike?



Spektri i pasojave të shkaktuara nga mungesa e energjisë elektrike është mjaft i gjerë. Problemet që evidentohen nga të anketuarit variojnë nga mungesa e ndriçimit, vështirësitë për të siguruar higjienën e nevojshme në mungesë të ujit të ngrohtë, efektet negative në shëndetin e tyre dhe deri në kushtëzimin e fëmijëve për të mësuar. Më konkretisht, të ftuar që të vlerësojnë pasojat e mungesës së energjisë elektrike në jetën e tyre në një shkallëzim nga 1-5, ku 1 është e barabartë me aspak e rëndësishme ndërsa 5 e barabartë me shumë e rëndësishme evidentohen problemet kryesore që implikon mungesa e këtij shërbimi. 84% e të anketuarve përgjigjen që problemi kryesor është mungesa e higjienës si pasojë e mungesës së ujit të ngrohtë dhe efektet negative në shëndet si pasojë e mungesës së higjienës dhe mungesës së ngrohjes. 83.5% vlerësojnë me 5 pamundësinë për të përdorur pajisjet elektroshtëpiake, 77.3% vështirësitë e fëmijëve për të mësuar dhe për të bërë detyrat e shkollës, 69.3% pamundësinë që fëmijët të argëtohen dhe 71.3% mungesën e televizorit për tu informuar (shih grafikët 9-13).


Grafik 9.

Mungesa e higjienës në munguesë të ujit të ngrohtë dhe efekti tek shëndeti juaj.




Grafik 10

Mos funksionimi i pajisjeve elektro - shtëpiake.




Grafik 11.

Vështirësitë e fëmijëve për të mësuar dhe për të bërë detyrat e shkollës.




Grafik 12.

Mungesa e televizorit për tu informuar.



Grafik 13.



Siç edhe është e kuptueshme nga këto statistika, mungesa e energjisë elektrike prek shumë aspekte të jetës së këtyre familjeve dhe mbart një peshë të rëndësishme në gamën e faktorëve që përcaktojnë mirëqënien e tyre. Kjo duhet theksuar për të shquar rëndësinë e këtij shërbimi që duhet klasifikuar në kategorinë e të drejtave themelore të njeriut dhe jo si një shërbim rëndësia jetike e të cilit mund të relativizohet. Gjendja e vështirë e krijuar nga mungesa e energjisë elektrike bëhet edhe më e papërballueshme për familjet që kanë në përbërjen e tyre me anëtarë me aftësi të kufizuara, fëmijë të vegjël, persona në moshë të thyer, persona me sëmundje kronike, etj.

Mungesa e këtij shërbimi, qoftë edhe përkohësisht, impakton jetesën e këtyre familjeve në të tashmen dhe në të ardhmen. Fëmijë që rriten në këto kushte nuk bëjnë një jetë të shëndetshme si në aspektin social ashtu edhe atë psikologjik. Mjafton të marrim parasysh se sa të disavantazuar kanë qenë në raport me bashkëmoshatarët e tyre gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin *online* në pamundësi për të ndjekur mësimin. Por kjo nuk ndodh vetëm në rrethanat e një gjendje të jashtëzakonshme pasi edhe rutina e tyre e shoqëruar me shumë anomali strukturore përfton përmasat e përjashtimit që në vegjëli.

Praktikisht janë të diskriminuar e të përjashtuar që në një fazë latente të jetës për sa nuk krijohet një shtrat i barazisë së mundësive për të zhvilluar potencialin e tyre. Në parim, e shprehur ndryshe, nën optikën e një drejtësie sociale pa u konsideruar barrë e tepruar, do të duhej që të paktën ti plotësoheshin kushtet bazë për të rritur shanset që ata/o që aktualisht janë fëmijë të shpëtonin nga cikli i varfërisë në të ardhmen.

62.5% e të anketuarve deklarojnë që pagesa e


faturave të energjisë elektrike zë nga 20% deri në 50% të buxhetit të tyre familjar dhe për rrjedhojë 87.4% prej tyre deklarojnë se e përdorin në mënyrë të kufizuar energjinë elektrike (shih Grafikonin 14). Në këto rrethana, përpos periudhave të ndërprerjes së energjisë elektrike dhe pasigurisë e ankthit të përmuajshëm nëse do ja dalin ta paguajnë energjinë elektrike, këto familje janë të detyruara që ta kufizojnë maksimalisht shfrytëzimin e saj edhe gjatë kohës që e përdorin. Ky racionalizim i skajshëm i shfrytëzimit të energjisë elektrike i kushtëzuar nga pamundësia për ta paguar mbart gjithashtu pasojat në cilësinë e jetës së këtyre familjeve.

Kufizimet në përdorimin e pajisjeve elektroshtëpiake për ngrohjen e ujit, për ngrohje apo ftohjen e mjedisit, madje edhe për ndriçim, mbështetur në pohimet e tyre shkaktojnë gjithashtu probleme me higjenën dhe shëndetin megjithëse përdoren burime alternative energjie si gaz i drutë kur është e mundur. Përballë kësaj situatë të vështirë me të cilën duhet të përballen, 50% e të anketuarve deklarojnë se ndjehen shumë të diskriminuar ndërsa 20.5% disi të diskriminuar. Megjithëse ky variabël nuk është i mjaftueshëm

për të matur diskriminimin fakti që rreth 70% e të anketuarve pohojnë që ndjehen të diskriminuar mbi një nivel mesatar, përbën një tregues domethënës. Në perceptimin e tyre mungesa e këtij shërbimi i bën të ndjehen të braktisur nga shoqëria dhe nga shteti i tyre, gjë që konfirmohet edhe nga gjetjet që trajtohen në seksionin pasardhës.


Grafik 14.

A e përdorni në mënyrë të kufizuar energjinë elektrike në shtëpinë tuaj?



Grafik 15.

Në cilat kategori përfituese të shtresave në nevojë të subvencionit bëni pjesë?



4.3 Marrëdhënia me institucionet dhe shkalla e informimit.

Të pyetur se në cilat kategori të shtresave në nevojë që duhet të subvencionohen bëjnë pjesë, 23.6% deklarohen si përfitues të ndihmës ekonomike, 18% pensionistë, 6.7% si paratetraplegjikë ndërsa 39.7% nuk bëjnë pjesë në asnjërën prej kategorive (shih Grafikonin 15). 78.4% e individëve pjesëmarrës në anketim pohojnë që nuk e përfitojnë pagesën prej 1200 lekësh të rimbursimit të energjisë elektrike (Grafiku 16). Kjo është një e dhënë e rëndësishme që tregon se sa të paktë janë në numër përfituesit e subvencionit së pari në raport me faktin që edhe në popullatën tonë të studimit sipas kategorive të vetëdeklaruar do të duhet të ishin të paktën 48.3% e tyre përfitues. Së dyti në raport me nevojat e të anketuarve, në përputhje me nivelin e tyre të varfërisë të trajtuar në dy sythat e mësipërm.

Arsyet për mospërfitimin e subvencionit të deklaruar nga të anketuarit janë të shumëllojshme, por si më të rëndësishmet mes tyre mund të listohen humbja e ndihmës ekonomike, një anëtar i familjes i punësuar megjithëse me pagë minimale, i është mohuar nga nënpunësit me arsyetimin se nuk bëjnë pjesë në kategoritë përfituese, dhe mungesa e informacionit mbi procedurat që duhen ndjekur për ta përfituar.


Grafik 16.

A e përfitoni pagesën mujore prej 1200 lekësh të rimbursimit për energjinë elektrike?

Përposkëtyregjetjeve që vërtetojnë sesa asimetrike është mbështetja e shtetit në raport me nevojat e shtresës së varfër, një e dhënë tjetër që shpërfaq një pengesë të konsiderueshme në ndryshimin e situatës është mungesa e informacionit. 93.1% e të anketuarve shprehën se nuk kanë informacion mbi ligje apo politika të posaçme për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë në lidhje me përfitimin e shërbimit të energjisë elektrike (Grafik 17). Po e konsiderojmë një pengesë që ndikon negativisht në ruajtjen e *statusquosë* sepse ky segment i shoqërisë në mungesë të informacionit nuk di se ku të drejtohet dhe çfarë të kërkojë në mënyrë që situata të ndryshojë në terma sistemikë.

Grafik 17.

A keni informacion mbi ligje apo politika të posaçme për mbrojtjen e qytetarëve që bëjnë pjesë në shtresat në nevojë në lidhje me përfitimin e shërbimit të energjisë elektrike?



Nga të dhënat rezulton se 40.5% e të anketuarve janë ankuar për ndërprerjen e energjisë elektrike dhe kanë kërkuar ndihmë për rilidhjen te zyrat e OSHEE, si dhe në pak raste edhe te bashkia e tek organizatat jo fitimprurëse por nuk kanë gjetur zgjidhje. Domethënë, përgjithësisht kanë reaguar për të gjetur një zgjidhje imediate të problemit të tyre por pa qenë në dijeni të politikave apo ligjeve që supozohet të mbështesin këto kategori në terma afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Kësisoj pjesa më e madhe prej tyre nuk dinë ku dhe si mund të përfitohet subvencionin prej 1200 lekësh në muaj, parashikuar në kuadër të heqjes së fashës mbrojtëse prej 300 kWh mbështetur në Vendimin nr. 8, datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave dhe VKM-ve të tjera. Po ashtu nuk janë në dijeni të ndryshimeve ligjore të rëndësishme si Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, i cili parashikon statusin e “klientit në nevojë” dhe duhet të garantojë për këto familje energjinë elektrike në një sasi të arsyeshme për të plotësuar nevojat bazë. Ky i fundit, megjithëse në parim mund të zgjidhë problemin e mungesës së energjisë elektrike për shtresat në nevojë, akoma

nuk është shoqëruar me VKM-në përkatëse që do ti bënte funksionalë dispozitat ligjore që parashikojnë “klientin në nevojë”. Kjo nuk do të thotë që çdo qytetar duhet të ketë njohuri juridike, por mungesa e informacionit redukton edhe fuqinë negociuese të këtij grupi shoqëror. Ndaj është me rëndësi që veç të tjerash, aktorët që punojnë me shtresat në nevojë të informojnë qytetarët dhe t’i përfshijnë në proceset advokuese me institucionet publike në mënyrë që në përfundim të gjendet një zgjidhje e përshtatshme. Në vijim të kësaj logjike, duke e shquar si shumë të rëndësishëm qëndrimin e vetë individit të prekur nga mungesa e këtij shërbimi, në mbyllje të këtij komponenti po evidentojmë disa prej rekomandimeve që artikuloohen nga të intervistuarit. Të pyetur se cila mund të ishte zgjidhja më e mirë që mund të ofrojë shteti në mënyrë që këto familje të sigurojnë energjinë elektrike në një sasi të pranueshme përgjigjet janë si më poshtë:

- Të ulët çmimi i energjisë për kWh;
- Të falen borxhet e prapambetura;
- Të ulët çmimi i aktmarrëveshjes;
- Të ndihmojë shteti që të kemi të paktën ndriçim në shtëpi;
- Të na jepen disa kWh falas;
- Të përcaktohet një sasi për të plotësuar nevojat bazë;
- Të ulen taksat që paguhen me faturën e dritave;
- Të krijohet një grup i posaçëm për shtresat në nevojë;
- Të punësohen njerëzit;
- Të rritet ndihma ekonomike;
- Të rriten pensionet.

5. Komponenti ekonomik – analiza e gjetjeve

5.1 Koncepti i varfërisë energjitike dhe standartet europiane

Energjia luan një rol themelor në krijimin e standardeve minimale të jetesës nëpërmjet shërbimeve që ajo mundëson. Sipas Raportit Insightenergy (2016), në sajë të energjisë krijohen kushtet për të pasur shtëpi të ngrohta, për të siguruar furnizimin me ujë, gatimin, ndriçimin, ftohjen dhe funksionimin e pajisjeve të tjera elektrike. Për shkak se çmimi i energjisë po rritet më shpejt se buxheti i një familjeje, numri i lartë i ndërtesave të izoluar dobët, pajisjet elektroshtëpiake joeficiente, të cilat çojnë në fatura më të larta të energjisë, Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian po implementojnë politika të ndryshme, ku nëpërmjet mekanizmave ekonomiko-socialë synojnë të përmbushin nevojat themelore të familjeve për energji.

Në vitin 2009, Komisioni Europian miratoi Direktivën 2009/72/KE dhe Direktivën 2009/73/KE, të cilat detyronin Shtetet Anëtare të hartonin plane kombëtare veprimi në përcaktimin e standardeve dhe zbatimin e tyre me synimin për të mos rënë nën nivelin e Varfërisë së Energjisë (VE). Sipas raportit të Insight_E(2015), një familje konsiderohet në varfëri energjitike kur ambjenti ku jetojnë nuk ngrohet/ ftohet sipas temperaturave të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) me një kosto të arsyeshme. Temperaturat e rekomanduara janë 21 gradë Celsius në dhomën e ndenjes dhe 18 gradë Celsius në dhomat e tjera. Sipas po të njëjtit raport, komponentët kryesorë që përcaktojnë nëse një familje përcaktohet se është në varfëri energjetike (VE) është një kombinim i shpenzimeve të larta të energjisë, të ardhurave të ulëta shtëpiake, ndërtesave dhe pajisjeve joefikase dhe nevojave specifike për energji shtëpiake.

Varfëria energjitike kuptohet kur një familje nuk ka mundësi të sigurojë një nivel të nevojshëm shoqëror dhe material të shërbimeve të energjisë në familje.¹¹⁾ Ky përkufizim është kryqëzuar edhe me perspektivat gjinore kritike sipas të cilave “diskutimet mbi varfërinë energjitike [...] ndërtojnë dhe përjetësojnë një “mit gjinor”

të grave në varfëri energjitike si të rrezikuara, të pafuqishme, të virtytshme dhe punëtore dhe të shtypura [...] pavarësisht nga evidencat e shumta të [...] grave si agjentë të jetëve të tyre dhe të ndryshimit” (Listo, 2018). Direktivat e Bashkimit Europian adresojnë çështjet e varfërisë së energjisë dhe konsumatorëve vulnerabël. Sipas Direktivës 2019/944 të BE-së në lidhje me varfërinë energjitike, Shtetet Anëtare janë të detyruara të përkufizojnë termin konsumator vulnerabël bazuar në kushtet dhe kontekstin e tyre specifik, si dhe të konsiderojnë ato masa të përshtatshme për të adresuar varfërinë energjitike. Rregullorja 1999/2018, i detyron vendet anëtare të mbledhin të dhëna në lidhje me varfërinë energjitike dhe të zbatojnë masa për zbutjen e saj. Deri më tani vetëm 7 vende kanë përkufizuar zyrtarisht varfërinë energjitike: Belgjika, Qipro, Spanja, Franca, Britania e Madhe, Irlanda dhe Rumania.¹²⁾ Neni 7 i Direktivës 2012/27 / EU (Eficiencia e Energjisë) detyron Shtetet Anëtare për të krijuar një skemë të eficiencës së energjisë. Në nenin 7 (7) (a) thuhet se skema përcakton kërkesa me karakter shoqëror në detyrimet e eficiencës, përfshirë edhe kërkesën që një pjesë e masave të eficiencës së energjisë të zbatohen me përparësi në familjet e prekura nga Direktivat e Paketës së Tretë e Energjisë . Ekziston gjithashtu prezumimi sipas të cilit konsumatorët vulnerabël aktualisht preken nga shqetësimet e papërbalueshmërisë të kostove të energjisë. Shtetet Anëtare në përcaktimet që ato japin për konsumatorët vulnerabël e lidhin kryesisht me cënueshmërinë “ekonomiko-sociale” bazuar në karakteristika personale si: mosha, kushtet shëndetësore etj. Ndërsa, të tjera shtete përqendrohen në vulnerabilitetin e energjisë bazuar në kritere si: statusi i qëndrimit në detyrë, sistemi i ngrohjes, kostoja e karburantit, kërkesat termike dimër/verë, etj. Pavarësisht përcaktimeve të vulnerabilitetit, masat që duhet të ndërmarrin shtetet synojnë energji eficiente dhe familje të cilat nuk bien në varfëri energjitike. Varfëria energjetike në mënyrë tipike prek familjet e pamundura nga një efekt i veçantë ose i kombinuar

11) S. Bouzarovski and S. Petrova, November 2015

12) ACER/CEER, 2019

që rezulton nga të ardhura më të ulëta, fatura më të larta energjie, ndërtesa dhe pajisje joefiçente (Pye et al. 2015). Në këtë kontekst, sipas përkufizimit zyrtar të propozuar nga rregullatori në Itali, një familje është vulnerabël kur më shumë se 5% e të ardhurave shpenzohen për energji elektrike dhe 10% për gazin.¹³⁾

Megjithëse përkufizimet mbi varfërinë energjitike nuk janë konsistente në shtete të ndryshme, të gjitha konsiderojnë elementë kryesore: te ardhurat dhe përbalueshmërinë për shërbimet energjitike jetike në shtëpi. Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian ofrojnë dy lloje të situatave të varfërisë energjetike: 1) familjet që shpenzojnë një pjesë të lartë të të ardhurave në energji; dhe 2) familjet që kanë shpenzime të pamjaftueshme në energji. Në këtë kontekst, kërkimi ynë është përqendruar në këto lloje situatash të varfërisë energjetike. Sipas E-Control (2013) në Austri, një familje konsiderohet në varfëri energjitike nëse të ardhurat e saj janë nën pragun e rrezikut të varfërisë dhe, në të njëjtën kohë, ajo duhet të mbulojë kostot e energjisë mbi mesataren. Në këtë kuptim, pragu i rrezikuar nga varfëria është 60% ose më pak e të ardhurave mesatare të familjeve. Sipas Bouzarovski (2014) varfëri energjie kemi atëherë kur ekziston pamundësia e një familje për të siguruar një nivel të domosdoshëm shoqëror si dhe material të shërbimeve të energjisë në shtëpi. Shqipëria, si Anëtare e Komitetit të Energjisë dhe njëkohësisht kandidatë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian (BE), është e angazhuar të respektojë të njëjtin standard në lidhje me nivelin e Varfërisë Energjitike. Energjia elektrike është një produkt bazik për aktivitetin jetësor të shoqërisë, prandaj përdorimi i saj kushtëzohet nga racionaliteti i konsumit të energjisë elektrike, ku maksimizimi i kushteve të jetesës kufizohet nga ekonomia familjare.

Varfëria energjitike është ndryshe nga varfëria dhe shoqërohet me një sërë pasojash për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve – sëmundje respiratore dhe kardiake, shëndet mendor, që për shkak të temperaturave të ulëta shoqërohet me stresin për fatura energjie të papërbalueshme. Varfëria e energjisë ka një efekt jo të drejtpërdrejt në shumë fusha politike - shëndet, mjedis dhe produktivitet. Adresimi i varfërisë energjitike ka

përfitime të shumëfishta të mundshme, si: më pak para të shpenzuara nga qeveria për shëndetësinë, ulje të ndotjes së ajrit, rehati dhe mirëqenie më të mirë, përmirësim të buxheteve familjare dhe rritje të përfshirjes sociale.¹⁴⁾

Një nga instrumentat më efektivë për këtë qëllim është kontrolli shtetëror mbi çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike. Çmimet e rregulluara bazohen në kostot reale dhe çmimi i ekuilibrit vendoset kundrejt kërkesave të furnizuesit, duke garantuar mbulimin e shpenzimeve, si dhe një fitim të arsyeshëm për vazhdimin e aktivitetit dhe realizimin e një programi të suksesshëm investimi. Nga ana tjetër, çmimet e energjisë elektrike lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me efektet sociale që shkaktohen mbi shtresat e ndryshme të popullsisë. Enti Rregullator i Energjisë (ERE), si një institucion i pavarur, ka detyrim ligjor mbrojtjen e konsumatorëve që furnizohen me energji elektrike nga efekti negativ që sjell një sistem monopoli i shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

Varfëria energjitike mund të shkaktohet nga disa faktorë, apo kombinimi i tyre :

- Të ardhura të ulëta, që shpesh lidhet me varfërinë në përgjithësi;
- Çmime të larta energjie, përfshirë dhe përdorimin e burimeve të energjisë respektivisht të larta (që në varësi të shtetit mund të jetë energji elektrike, karburant vendas)
- Efiçencë energjie e ulët në shtëpi, psh. izolim i ulët dhe sisteme ose aparatura ngrohje të vjetra dhe jo eficientë.

Vendimi nr. 8, datë 14.1.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj”, përcakton se përfitojnë kompensim familjet me ndihmë ekonomike, kryefamiljarët në pensione pleqërie e invaliditeti, familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët dhe punonjësit buxhetorë me pagë nën 35 mijë lekë në muaj. Aktualisht, sipas autoriteteve publike, janë 203,928 familje që marrin kompensim për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Pavarësisht politikave dhe instrumentave të përdorura nga Institucionet

13) Schweizer-Ries, P. 2009

14) <https://www.empowermed.eu/wp-content/uploads/2020/09/Varferia-Energjitike.pdf>

Publike, matja e varfërisë energjetike mbetet një element kyç në përcaktimin e shkallës dhe thellësisë së problemit në nivel kombëtar. Rritja e shpenzimeve të energjisë familjare e kombinuar me mungesën e të ardhurave mesatare të familjeve si dhe me rritjen e kostove të energjisë, ku më të rrezikuarit janë familjet me të ardhura të ulta passjell nevojën për ndryshime ligjore.

Pyetësi eksploroj një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me koston e energjisë dhe varfërisë, duke iu përgjigjur pyetjeve si: *Kush janë “të varfrit e energjisë”?* *Cilat janë ndikimet për familjet që jetojnë me të ardhura të ulëta dhe përballen me fatura të papërbalueshme të energjisë?* *Cilat janë mundësitë për zhvillimin e politikave dhe praktikave për të lehtësuar varfërinë energjetike të këtij target grupi nga institucionet publike?* Duke iu referuar konceptit të varfërisë energjetike, konsumatorët vulnerabël në sektorin e energjisë janë familje me të ardhura të ulta, përdorimi i burimeve alternative të energjisë nga këto familje duke rritur kostot për ngrohjen e shtëpisë, mungesa e një banese të zakonshme, si dhe përdorimi joeficient i energjisë. Grupi më i prekshëm ndaj rritjes së çmimeve të energjisë janë këto familje, të cilat në mungesë të të ardhurave nuk kanë aftësinë për t’u përshtatur në teknologji më efçente për shkak të kostove të larta. Këto grupe familjesh përballen me pamundësinë për të paguar faturat e tyre të energjisë, duke i kthyer ata në debitorë dhe më pas duke shkaktuar ndërprerje të energjisë.

Përveç të tjerave, studimi nxori në pah strukturën e konsumit familjar të energjisë elektrike, që do të thotë se sa energji elektrike konsumohet nga çdo familje, për çdo shërbim të marrë nga energjia, si dhe sa përqind të të ardhurave familjare mujore shkojnë për konsumin e energjisë elektrike, si indikator themelor i Varfërisë Energjetike.

Projekti vlerësoi ndikimin dhe njohjen publike të varfërisë energjetike në qytetet: Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Pogradec, Fier, Berat dhe Korçë, hulumtoi strategjitë dhe mekanizmat financiarë për të mbështetur familjet në varfëri energjetike. Kampioni për këtë studim ishte 924 të intervistuar, që përfaqësojnë 4,620 anëtarë të familjeve pasi një pjesë e të intervistuarve nuk i janë përgjigjur pyetjeve ekonomike. Të dhënat u mblodhën përmes intervistave ballë për ballë, gjatë periudhës shtator - tetor 2020. Informacioni i mbledhur shërbeu për të analizuar

situatën e këtyre familjeve në kuadër të varfërisë energjetike.

Pavarësisht ndryshimeve strukturore socio-ekonomike në qytetet e targetuara, familjet më të rrezikuara nga varfëria energjetike përfshijnë gjithashtu: Familje me të ardhura të ulëta (veçanërisht ato që nuk përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike), të papunë ose në pension, të moshuarit që jetojnë vetëm, familje me një prind të vetëm (i divorcuar ose i ve), persona me aftësi të kufizuar ose me sëmundje kronikë, nivel i ulët arsimor, familje të pakicave etnike dhe familje që përdorin pajisje elektroshtëpiake joefçente. Kjo pjesë e studimit ka synim të përcaktojë dhe të vlerësojë barrën financiare që i ngarkohet buxhetit të shtetit nga familjet e përfshira në pyetësor dhe zgjerimi i grupit të klientëve në nevojë.

5.2 Metoda

Komponenti ekonomik i këtij studimi u mbështet mbi një metodë të përzier cilësore dhe sasiore, si dhe rishikim literaturë mbi konceptin e VE dhe shtresave në nevojë.

Në përcaktimin e kërkesave minimale për energji elektrike të familjeve në nevojë, studimi analizoi dhe mori në konsideratë politikat dhe strategjitë kombëtare aktuale për mbështetjen e kategorive të familjeve në nevojë, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të përballojnë financiarisht pagesën e faturës së energjisë elektrike, duke plotësuar standardet minimale të jetës.

Mbështetur në vendimin nr 8, datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 kw orë për faturimin e çmimit të energjisë elektrike*”, i ndryshuar, përfitojnë kompensim deri në masën 648 lekë në muaj kategori që hyjnë në kuptimin e “*klientit në nevojë*”. Gjithashtu, po të njëjtat kategori të përfshira në këtë VKM 8/2015 përfitojnë kompensim edhe në bazë të VKM nr. 565, datë 9.8.2006, “*Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike*”, i ndryshuar, në masën 500 Lekë. Në kuadër të këtij studimi, kompensimi i dhënë nga shteti shqiptar për kategoritë e parashikuara në këto Vendime do të llogaritet në masën 1.148 Lekë në muaj.

Ky studim është në linjë me konceptin e varfërisë së energjisë të trajtuar nga vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Informacioni i përdorur për të zbatuar vlerësimin dhe masat e varfërisë energjetike u mbështetën në metodologjinë e studimit të hartuar nga ekspertët e projektit. Kampioni i studimit, në lidhje me këtë komponent, përbëhet nga 924 të intervistuar, që përfaqësojnë 4,620 anëtarë të familjeve të shpërndarë në tetë Bashkitë: Tiranë, Elbasan, Berat, Fier, Pogradec, Durrës, Shkodër dhe Korçë. Treguesit kryesorë dhe arsyet e mbështetura për zgjedhjen e kampionit janë si më poshtë:

- Mosha e Popullsisë – grupmosha më e ulët ose e barabartë 18 vjeç ose 65 vjeç e lart është më e prekshme ndaj mungesës së cilësisë së jetës, për ambient të ngrohtë, si dhe me standardet e shëndetit dhe higjienës sipas OBSH-së për shkak të aftësisë së tyre të ulët adaptive.
- Të ardhurat mesatare mujore për frymë - i referohet kapacitetit financiar për të zbatuar masa për përmirësimin e kushteve të jetesës, përkatësisht përmes blerjes dhe përdorimit të pajisjeve elektroshtëpiake efçente të ngrohjes dhe ftohjes.
- Niveli i arsimit - ky tregues i referohet posaçërisht përqindjes së popullsisë me diplomë universitare. Supozimi është që një person me një diplomë universiteti është potencialisht më i vetëdijshëm dhe ka qasje më të mirë në informacion mbi masat e efçencës së energjisë, duke përfshirë mundësitë e financimit, stimujt socialë dhe veprime të tjera mbështetëse për blerjen dhe instalimin e teknologjisë së ngrohjes dhe ftohjes.
- Shkalla e papunësisë - supozon që njerëzit e papunë përgjithësisht kanë vështirësi financiare, më pak motivim për të zbatuar masa për zbutjen e varfërisë energjetike dhe standarde jetese nën minimumin jetik .

• Faktorët socio-kulturor – supozon që grupe të ndryshme vulnerabël kanë qasje të ndryshme ndaj kushteve socio materiale në shërbimet energjitike në familjet e tyre. Psh: grupet rome mund të qëndrojnë në kohë të gjata me shërbim energjie të ndërprerë, duke pasjell mosarsimim apo mungesë kujdesi shëndetësor për fëmijët.

Studimi përdori një teknikë të marrjes së kampionit për shkak të madhësisë së vogël të popullsisë dhe mblodhi informacion mbi praktikatat e energjisë duke u përqendruar në llojet e lëndëve djegëse të gatimit dhe pajisjeve, si dhe kostot e energjisë elektrike të përdorur çdo muaj për nevojat themelore si: gatimi, ngrohja, ndriçimi, higjiena personale.

Pyetëtori përbëhet nga 44 pyetje të përgjithshme që pasqyrojnë disa nga dimensionet kryesore të Situatës së Varfërisë së Energjisë për shtresat në nevojë. Pyetëtori ndërthur pyetje të hapura dhe pyetje me zgjedhje të shumëfishta me përgjigje të paracaktuara, duke u ofruar të intervistuarve mundësinë për të zgjedhur dhe renditur në mes të disa opsioneve ose mundësinë për të vlerësuar nga një shkallë “shumë të ulët” në “shumë të lartë”. Për këto pyetje, kishte një hapësirë opsionale për të elaboruar më tej përgjigjen. Kjo pjesë e hapur konsiderohet e një rëndësie të madhe për një studim të këtij lloji pasi kontribuon në përmirësimin e interpretimit të rezultateve të përgjithshme dhe ofron informacione të vlefshme shtesë për autoritetet publike.

Instrumenti i fundit i pyetësorit përbëhet nga pyetje që lidhen me llojet e energjisë dhe pajisjet shtëpiake të familjeve, kostot e energjisë dhe praktikatat e konsumit, si dhe faktorët që ndikojnë në zgjedhjet e burimeve të tjera të energjisë për përdorim familjar.

Faktorët e Varfërisë së Energjisë



Kufizimet e metodologjisë konsistojnë në:

- Target grupin e të intervistuarve, është një grup vulnerabël me mungesë të theksuar arsimimi;
 - Informacioni për të ardhurat mujore familjare dhe konsumi i energjisë bazuar në deklaratime dhe perceptime personale të të intervistuarve; Kjo e fundit në jo pak raste tregon për mospërputhje midis realitetit të jetës dhe asaj që reflektohet në përgjigjet e tyre, si psh: mbi 30% të të ardhurave për energji.
 - Vështirësi në përgjigje, pavarësisht pranisë dhe asistencës së grupit të punës;
- Këto kufizime do të kushtëzojnë dhe disa nga gjetjet e këtij studimi.

5.3 Të dhënat dhe analiza


Pyetësi paraqet demografinë dhe karakteristikat ekonomiko-sociale të popullsisë së studimit. Rreth 65% e të intervistuarve përfitonin ndihmë ekonomike, pension, ishin të papunë ose me aftësi të kufizuara dhe vetëm 18% ishin të vetëpunësuar, ku përfshihet dhe puna informale. Shumica e

familjeve jetonin në kushte ekstremisht të varfra. Familjet e përfshira në studim përdorin lloje të ndryshme të burimeve të energjisë për të përmbushur aktivitetet bazike të familjes. Nga studimi konkludojmë se 55% e familjeve kryesisht përdorin drurin si burim energjie për ngrohje. Përveç drurit, rreth 19% e familjeve të intervistuarra ngrohen me energji elektrike, 11% ngrohen me gaz dhe rreth 8% në total ngrohen me gaz, dru, ose me dru dhe energji elektrike. Ndërkohë që, studimi i Bankës Botërore mbi Ngrohjen nga Biomasa për Ballkanin Perëndimor tregon që në Shqipëri ngrohja e banesave realizohet nga energjia elektrike 62%; me dru zjarri (dhe pelet) 20% dhe me gaz 8%. Kjo tregon se të intervistuarit e përzgjedhur janë jashtë fashës mesatare të studimit të mësipërm.¹⁵⁾

Druri është lëndë djegëse shtëpiake më e përdorshme, siç tregohet në Grafikon 18 më poshtë.

15) World Bank (2017) Biomass-Based Heating in the Western Balkans.


Grafik 18



Rreth 51% e familjeve në këto Bashki përdorin energjinë elektrike për ndriçim, 23% e familjeve e përdorin energjinë elektrike për ngrohje, gatim dhe ndriçim, 4% e përdorin energjinë për ngrohje ose ndriçim, ndërsa 11% e tyre përdorin energji për gatim ose edhe për ndriçim. Të gjitha këto familje përdorin energji elektrike për një shërbim bazik sikurse është ndriçimi. Nevoja për të pasur akses në energji elektrike, minimalisht një dritë

është një nga të drejtat themelore të njeriut, parashikuar dhe në politikat e OKB-së. Ky hulumtim nxori në pah faktin se çmimi i lartë i energjisë elektrike kufizon përdorimin e saj tek konsumatorët vulnerabël.


Grafik 19



Kjo situatë reflektohet gjithashtu në të dhënat që dolën nga analiza e pyetësorëve kur familjet u pyetën në lidhje me mënyrat e ngrohjes së ujit. Ashtu sikurse shihet dhe në grafikun e mëposhtëm, 37% e familjeve e ngrohën ujin me dru, 32% përdorin energjinë elektrike për të ngrohur ujin, 13% e ngrohën ujin me gaz dhe

dru, ndërsa rreth 17% në total e ngrohën ujin me dru, energji elektrike, gaz dhe tjetër. Kjo situatë tregon që kemi të bëjmë me shtresa vulnerabël, të cilat referuar konceptit të varfërisë së energjisë nuk përmbushin kushtet minimale të jetesës si për të mbajtur një shtëpi të ngrohtë ashtu edhe me mënyrat e ngrohjes së ujit.

Grafik 20



Në këtë kontekst, kjo mund të shpjgohet me çmimin e lartë e të papërbalueshëm të energjisë elektrike nga ana e këtyre familjeve. Aktualisht, çmimi i energjisë elektrike për familjet përcaktohet në 9.5 lekë / kWh. Në familjet e intervistuar, kostoja totale mesatare e tyre është 6,246 lekë në muaj, ekuivalente me një konsum mesatar të energjisë elektrike 657 kWh në muaj. Sipas studimit, 79% nuk përfitojnë nga skema e rimbursimit të energjisë. Kjo vjen si pasojë e mosplotësimit të një ose disa kushte ligjore për

të qenë pjesë e skemës së rimbursimit: a) borxhi i akumuluar nga faturat e papaguara të energjisë elektrike ose b) mungesa e matësit të energjisë. Familjet e intervistuar pretenduan se u mungon informacioni dhe komunikimi me kompaninë e furnizimit. Disa nga të intervistuarit shprehën: “Të kisha mundësi që pagesën e lidhjes së energjisë, ta kisha me këste. Të ngrihet një grup monitorimi. Gjysmën e faturës të na e paguaj shteti. 2 mijë lekë në muaj mund të paguaj për çmimin e energjisë. Të ulet çmimi dhe të na falin

prapambetjet. Drita falas etj.”


Energjia elektrike, edhe pse në kushtet e përdorimit minimal, nuk është e përbalueshme nga familjet e intervistuar. Komentet e tyre shprehin qartë nevojën për t’u mbështetur nga shteti në forma të ndryshme, me qëllim aksesin dhe marrjen e furnizimit me energji, si element kyç për të jetuar në kushte normale.

Grafiku 21 paraqet shpërndarjen e përqindjes së familjeve sipas të ardhurave mujore. Familjet me të ardhura nën 20,000 ALL, të ardhura minimale, përbëjnë rreth 59% të kampionit. Pavarësisht nga burimi i të ardhurave (d.m.th. punësimi me kohë të pjesshme, pjesë e skemave të ndihmës ekonomike, pension, punë informale apo invaliditet), familjet

deklaruan të ardhura mesatare që variojnë midis 20,000 lekë dhe 50,000 në muaj. Të ardhurat më të larta mujore të regjistruara ishin 50,000 ALL dhe përbëjnë 12% të familjeve të intervistuar.

Në grafikun e mëposhtëm reflektohet shpërndarja e të ardhurave mujore të familjeve në studim, ku vlen për tu theksuar se 58.4% e familjeve kanë të ardhura mujore nën 20,000 ALL lek, 16.3% e tyre kanë të ardhura nga 20,000 – 25,000 ALL, 7.7% tyre kanë të ardhura nga 25,000 – 30,000 ALL, 5.7% kanë të ardhura mujore nga 30,000 - 40,000 lek dhe 12% kanë të ardhura mbi 50,000 ALL. Këto të dhëna janë bazuar në deklaratimet personale dhe mbi bazën e perceptimit të të intervistuarve.

Grafik 21



5.4 Modelet e shpenzimeve të energjisë – Konsumi

Në përgjithësi, familjet e përfshira në studim përdorin dy ose më shumë burime energjie për realizimin e aktiviteteve jetësore në përditshmëri të tyre. Ndërsa druri raportohet si lëndë djegëse më e përdorur për gatim, ngrohje dhe ngrohje të ujit, shpenzimet mesatare mujore për dru zjarri janë relativisht më të ulëta në krahasim me lëndët e tjera djegëse (1m³ = 5000 ALL). Sidoqoftë, në shumicën e familjeve, buxheti i pjesës së energjisë rritet me shpenzimet shtesë të përdorura në vend të përdorimit të energjisë elektrike. Një pjesë e familjeve nuk janë të lidhura me rrjetin kryesor të furnizimit me energji elektrike sepse nuk janë

në gjendje të paguajnë për energjinë elektrike. Për këtë arsye, familjet të cilat nuk kanë akses në një rrjet për furnizimin me energji elektrike varen nga lëndët e tjera djegëse me kosto më të lirë për të përmbushur nevojat e tyre mujore për energji, si dhe plotësimin e nevojave jetësore. Mungesa e furnizimit me energji është ngushtësisht e lidhur me të drejtat e tjera themelore, si e drejta për edukim, e drejta për shëndet mendor, higjiena personale. Të intervistuarit shprehën se: *“Vështirësia e mësimin të niprave .Informimi pa televizor, ujë për të larë etj. Jemi të sëmurë dhe kemi nevojë për energji. Mësimet nuk i bëjnë. Psikologjikisht jemi rëndë. Problem për higjenë, fëmijë për t’u shkolluar, ujë të rrjedhshëm, mosfunksionimi i lavatriçes etj.”*

Për të llogaritur konsumin e energjisë elektrike, janë pjestuar shpenzimet e energjisë me çmimin e energjisë elektrike që është 9,5 lekë/kWh. Për më tepër, janë marrë parasysh dy grupe të të ardhurave që lidhen me konsumin e energjisë mesatarisht. Nga hulumtimi rezultoi se të ardhurat e familjeve variojnë nga më pak se 20,000 ALL të ardhura minimale dhe mbi 50,000 ALL të ardhura maksimale. Tabela nr.1 na jep një panoramë të familjeve me të ardhura minimale. Nga tabela shikojmë se nga kampioni i analizuar kemi 540 familje me të ardhura minimale, nën 20.000 ALL nga të cilat: 445 familje përdorin 10% të të ardhurave të tyre për energji elektrike, 51 familje përdorin 15% të të ardhurave të tyre për energji elektrike, 24 familje përdorin 20% të të ardhurave të tyre për energji elektrike, 16 familje përdorin 30% të të ardhurave të tyre për energji elektrike dhe 4 familje përdorin 40% të të ardhurave për energjinë elektrike. Nga këto të dhëna mund të konkludojmë që këto familje konsiderohen energjitikisht të varfëra, sepse më shumë se 10% e të ardhurave shkojnë për konsumin e energjisë elektrike.

Konsum energjie (KW)	Përqindja e të ardhurave që shkojnë për konsum	Numri i familjeve
211	10%	445
315	15%	51
421	20%	24
631	30%	16
842	40%	4


Tabela 1: Familje me të ardhura nën 20,000ALL

Sipas studimit të BB mbi Ngrohjen nga Biomasa për Ballkanin Perëndimor e vitit 2017, shpenzimet mesatare vjetore për ngrohje dhe energji në nivel familje janë rreth 829 EUR, ose 10.4% e shpenzimeve të të ardhurave vjetore në rajonin e Ballkanit Perëndimor, gjë që flet për varfëri energjitike (përcaktuar në raport si “shpenzim energjie që përfaqëson të paktën 10% e të ardhurave familjare”) në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Mal të Zi, dhe Serbi. Nisur nga ky raport mund të thuhet se e gjithë mostra e studimit ndodhet në kushtet e varfërisë energjitike pasi shpenzojnë më shumë se 10% të të ardhurave për të plotësuar nevojat të reduktuara për shërbime energjie.

Në Grafikon 22 tregohet pjesa e të ardhurave kundrejt konsumit të energjisë elektrike për familjet me të ardhura nën 20,000 ALL. Grafiku më poshtë tregon se nga 540 familje me të ardhura nën 20,000 ALL, 445 prej tyre, pra 82.4% e tyre shpenzojnë 10% të të ardhurave të tyre për energji elektrike. Kjo shpjegohet me faktin se këto familje jetojnë në varfëri ekstreme, duke i bërë të pamundur ekonomikisht për furnizimin me energji elektrike dhe shërbime të tjera ngushtësisht të lidhura me të.

Këto familje përbëjnë rreth 59% të kampionit të studimit. Të dhënat tregojnë qenien e tyre si konsumator vulnerabël ose klient në nevojë, në kuptim të Ligjit nr.43/2015 dhe të qenit në Varfëri Energjitike. Pavarësisht se nuk arrihet fasha prej 300 kWh, ku sipas kuadrit ligjor në fuqi këto familje duhet të jenë të përfshira në skemën e rimbursimit, vazhdojnë dhe janë të detyruar të paguajnë energjinë që konsumojnë. Mungesa e arritjes së kësaj fashje tregon se këto familje kanë zbritur nën minimum shërbimet e energjisë dhe sërish nuk përfitojnë nga mekanizmat financiare të vendosur nga qeveria shqiptare.


Grafiku 22



Në grafikun 23 tregohet pjesa e të ardhurave kundrejt konsumit të energjisë elektrike për familjet me të ardhura nga 20,000 ALL – 25,000 ALL. Grafiku më poshtë tregon se nga 151 familje me të ardhura nën 25,000 ALL, 16.3 % të kampionit të studimit, 101 prej tyre, pra 66.9% e tyre shpenzojnë 10% të të ardhurave të tyre për energji elektrike, 13 familje pra 8.6% e tyre shpenzojnë 20% të të ardhurave të tyre për energji elektrike, 32 familje pra 21.2% e tyre shpenzojnë 30% të të ardhurave të tyre për energji elektrike dhe vetëm 5 familje pra 3.3 % e tyre shpenzojnë 40% të të ardhurave të tyre për energji elektrike. Ashtu sikurse u konstatua nga grafiku 22, për familjet me të ardhura nën 20,000 ALL dhe

në familjet me të ardhura nga 20,000 ALL – 25,000 ALL peshën kryesore e zënë familjet që shpenzojnë 10% të të ardhurave për energji elektrike. Këto familje përballen me një konsum energjie prej 263 kWh. Pavarësisht se nuk arrihet fasha prej 300 kWh, ku sipas kuadrit ligjor në fuqi këto familje duhet të jenë të përfshira në skemën e rimbursimit, vazhdojnë dhe janë të detyruar të paguajnë energjinë që konsumojnë. Kjo shpjegohet me faktin se këto familje jetojnë në varfëri ekstreme, duke i bërë të pamundur ekonomikisht për furnizimin me energji elektrike dhe shërbime të tjera ngushtësisht të lidhura me të.


Grafiku 23



Në grafikun 24 paraqitet një panoramë e familjeve me të ardhura nga 25,000 ALL - 30,000 ALL ku në total kemi 71 familje nën vëzhgim me këto të ardhura. 11 familje, 15.5% e tyre, shpenzojnë 10% të të ardhurave për energji, përkthyer në një konsum prej 316 kWh, 31 familje, 43% e tyre, shpenzojnë 30% të të ardhurave për energji, përkthyer në një konsum prej 947 kWh, pjesa

tjetër shpenzojnë 40 - 50% të të ardhurave për energji. Familjet me të ardhura 25,000 – 30,000 ALL përbëjnë 7,7% të kampionit të studimit, marzhi i gabimit që reflektohet në përqindjen e të ardhurave në konsumin e energjisë elektrike (40 – 50%) nuk ndikon në gjetjet përfundimtare të përcaktimit të Varfërisë Energjitike.


Grafiku 24



Në grafikun 25 paraqitet një panoramë e familjeve me të ardhura nga 30,000 ALL - 40,000 ALL ku në total kemi 53 familje me këto të ardhura, 5.7% të kampionit. 19 familje, 35% e tyre, shpenzojnë 10% të të ardhurave për energji, përkthyer në një konsum prej 421 kWh, 14 familje, 26% e tyre, shpenzojnë 15% të të ardhurave për energji, 16 familje, 30% e tyre, shpenzojnë 30% të të ardhurave për energji dhe pjesa tjetër, 4 familje

shpenzojnë 40 - 50% të të ardhurave për energji. Njësoj si më sipër, familjet që zënë peshën më të madhe në këtë fashë konsumojnë 421 kWh. Aplikimi i skemës së rimbursimit dhe për këtë fashë, zë një peshë të rëndësishme në buxhetin e këtyre familjeve, duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe marrjen e shërbimeve të tjera jetësore të domosdoshme.


Grafiku 25



Në grafikun 26 paraqitet një panoramë e familjeve me të ardhura mbi 50,000 ALL ku në total kemi 112 familje me këto të ardhura, 12% të kampionit. 50 familje, 45% e tyre, shpenzojnë 10% të të ardhurave për energji, përkthyer në një konsum prej 526 kWh. Këto familje mund të konsiderohen si përjashtim nga kampioni i studimit, për shkak të niveli të lartë të të ardhurave. Varfëria Energjetike, si koncept bazohej në dy faktorë kryesore: nivelin

e të ardhurave për konsum energjie, që duhet të jetë më e madhe ose baraz me 10%; ose mungesa e efikasitetit në konsumin e energjisë elektrike. Ashtu sikurse familjet e mesiperme, mbështetja e shtetit mund të konsistojë në sigurimin e përdorimit të energjisë elektrike në mënyrë eficiente. Psh: Këto familje përdorin për ngrohje energjinë elektrike, por me pajisje si rezistencë ose kaloriferë, që kërkojnë konsum të lartë energjie në kWh.

Grafiku 26



Raporti DEC, 2013 përcakttoi pragun e Varfërisë së Njesisë së Vëzhgimit. Ky është një tregues i thjeshtë, i cili u miratua në Mbretërinë e Bashkuar dhe mat një vlerë absolute për varfërinë energjetike. Në këtë kontekst, vlera e të ardhurave të shpenzuara për energji me më shumë se 10% të familjeve ishte treguesi kryesor i varfërisë energjetike. Nga hulumtimi jonë ne konkludojmë se familjet e kalojnë pragun për varfërinë energjetike pasi përdorin më shumë se 10% të të ardhurave të tyre për të mbuluar konsumin e energjisë elektrike. Për përcaktimin e shkallës së varfërisë energjetike në qytetet e targetuara u përdor një qasje e bazuar në shpenzimet e

familjes duke përcaktuar që një familje është e varfër energjetikisht kur 10% ose më shumë e të ardhurave të saj shpenzohen vetëm për energji. Tabela më poshtë paraqet një panoramë të të ardhurave mesatare mujore të familjeve si dhe përqindja që zë konsumi i energjisë elektrike tek të ardhurat mujore, ku mesatarisht është 18%. Në këtë kontekst, mund të themi që konsumi i energjisë elektrike zë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave mujore, duke tejkaluar pragun e varfërisë së energjisë, sipas teorive empirike me konceptin e varfërisë së energjisë. Tabela tregon se konsumi mesatar i energjisë elektrike për të gjithë familjet në studim është 657 kWh.

Te ardhura mesatare mujore (ALL)	Kosto mesatare mujore per konsum energjie (ALL)	Perqindja e te ardhurave qe shkon per konsum energjie (%)	Perqindja e familjeve (%)
<i>më pak se 20,000</i>	2.507	13%	58.4%
<i>deri në 25000</i>	4.073	16%	16.3%
<i>deri në 30000</i>	6.733	22%	7.6%
<i>deri në 40000</i>	8.150	20%	5.7%
<i>më shumë se 50000</i>	9.763	20%	12%
Mesatarja Totale	6.246	18%	


Tabela 2 Panorama e kampionit me variable mesatare

Të ardhurat mesatare mujore (ALL)	Përqindja e të ardhurave që shkojnë për konsum energjie (%)	Sasia e parave mesatarisht mujore për konsum energjie (ALL)	Konsumi mesatar i energjisë (kWh)
34,700	18%	6.246	657

Tabela 3 Mesatarja e variableve kryesore ne percaktimin e varfërisë energjitike.

Pavarësisht marzhit të gabimit dhe kufizimeve të studimit, konkludojmë që për qindja e të ardhurave që shkojnë për konsumin e energjisë nga kampioni në studim është 18%, pra mbi pragun 10% të varfërisë energjitike. Kjo nxjerr në pah nevojën dhe kërkesën për mbështetje të këtyre familjeve nga shteti me: - kompesim ose - investim në efikasitet.

Grafiku 27



6. Konkluzione dhe Rekomandime

Me gjithë kufizimet e tij studimi arriti të japë disa indikatorë mbi situatën social-ekonomike të shumë familjeve të pamundura dhe impaktit që energjia elektrike ushtron në situatën e tyre. Në funksion të gjetjeve në studim, konkludohet se energjia elektrike si një përbërës i rëndësishëm i mirëqenies së qytetarëve dhe gëzimit të të drejtave të tyre, është kusht i domosdoshëm për përfshirjen e grupeve më të pamundura të shoqërisë në jetën sociale, kulturore, ekonomike. E drejta për strehim të përshtatshëm dhe energji elektrike janë kushte për garantimin e disa të drejtave të tjera themelore si: e drejta e shëndetit fizik dhe mendor, e drejta për arsim, e drejta për tu informuar, e drejta për jetë familjare dhe private, e drejta për një jetë dinjitoze.

Privimi i qytetarëve nga ky shërbim, vështirësia për ta siguruar, problemi i garantimit në vazhdimësi, barra e tepruar ekonomike në të ardhurat e tyre, pasiguria e qasjes ndaj shërbimit, paqartësia dhe pamjaftueshmëria e akteve kompensuese, mospasja e informacionit të nevojshëm, përbëjnë disa nga aspektet më të mprehta që kërkojnë domosdoshmërisht nxjerrjen e aktit nënligjor për statusin e “klientit në nevojë”.

Varfëria e energjisë është një problem aktual në Bashkimin Evropian, si dhe në Ballkan, përfshirë dhe Shqipërinë, me pasoja të të dëmshme për shëndetin, edukimin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së popullsisë.

Jetesa në një shtëpi që plotëson standardet minimale është një e drejte themelore, parashikuar

dhe ne Objektivat e OKB-se.

Familjet që përjetojnë varfëri energjetike kanë shfaqje të lartë të sëmundjeve fizike, probleme të shëndetit mendor dhe fizik.

Një nga elementët kryesorë të studimit për përcaktimin e kërkesave minimale të furnizimit me energji elektrike të familjeve në nevojë është padyshim analiza dhe shqyrtimi i politikave dhe strategjive qeveritare për të mbështetur kategoritë e klienteve në nevojë, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të paguajnë faturën e energjisë elektrike.

Target grupi i intervistuar bazuar në të ardhurat e tyre financiare dhe shërbimet që ato marrin nga furnizimi me energji elektrike jeton në kushte ekstreme të dobëta ekonomike.

Pjesa e kostos së energjisë elektrike për këto familje zë 18% të pjesës së të ardhurave të tyre mesatare mujore, duke marrë parasysh që ata e konsiderojnë energjinë elektrike si burim primar për plotësimin e nevojave të tyre themelore.

Sipas legjislacionit në fuqi, ekzistojnë dy skema në mbështetje të klientëve në nevojë që ulin faturën e tyre të energjisë elektrike, nga e cila përfitojnë 203,928 abonentë. Grupi 1 përfiton nga ulja e çmimit për konsumin e 300 kWh të para dhe rritja e çmimit të energjisë deri në 200kWh, me një shumë mujore prej 1,120 lekësh; Grupi 2 që përfiton nga rimbursimi i një shume mujore prej 2000 lekësh ose 1400 lekësh dhe qvlihet vetëm me personat e verbur dhe personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, me kujdestar dhe pa kujdestar. Pra, mekanizmat financiarë për të adresuar VE në Shqipëri janë rimbursimi, ose financimi i drejtpërdrejtë (ndonëse dhe ky në një vlerë shumë të ulët dhe i kufizuar për shkak të kritereve).

Kampioni i studimit është në kushte jetese më të këqija në krahasim me klientët ekzistues përfitues së skemës së subvencioneve. Grupi i intervistuar duhet të jetë në vëmendjen e institucioneve përkatëse publike për përfshirjen e tyre në skemën e subvencioneve dhe kategorinë e klientëve në nevojë në kuptim të kuadrit ligjor. Dhe më gjerë edhe për qytetarë të tjerë, duhen sugjeruar edhe mekanizma të tjerë si: (i) mbështetje me investime për masa për efikasitet energjetik; (ii) informim dhe mbështetje me skema të tjera financimi.

Kompania e Shpërndarjes së Furnizimit me Energji (Grupi OSSHE) ka përmirësuar ndjeshëm performancën e saj në vitet e fundit, ku humbjet financiare dhe teknike janë ulur nga 45.3% në 21.79%, si dhe mbledhja e pagesave të energjisë elektrike ka arritur nivelin e 98.4% në 2019. Duke marrë parasysh performancën financiare dhe teknike të OSSHE Group, ku mund të përmendim këtu arkitimet e OSSHE - Niveli i Arkitimeve në OSSHE 58.87 Mld Leke për Vitin 2020, në buxhetin e përgjithshëm të qeverisë mund të parashikohet një zë i veçantë për zgjerimin e mëtejshëm të kategorisë së klientëve në nevojë.

Është thelbësore të tregohet kujdes i shtuar për grupet vulnerabël pasi vështirësitë e krijuara nga situata ekonomike, si dhe nga situata e pandemisë Covid 19 kanë ndikuar negativisht në zinxhirin e ekonomisë për punësim dhe të ardhurat duke rritur rrezikun e varfërisë së energjisë për këto konsumatorë vulnerabil. Njëkohësisht, sidomos në kohën e pandemisë por jo vetëm, familjet e pamundura për shkak të problemeve me energjinë si dhe ndërprejes së saj, rrezikohen në garantimin e të drejtës për arsim të fëmijëve të tyre. Në këtë mënyrë thellohen më shumë jo vetëm pabarazitë ekonomike por edhe diferencimet sociale dhe kulturore, si dhe shtohet pamundësia reale për mundësi të barabarta.

Nisur nga gjetjet e këtij studimi disa nga rekomandimet që mund të jepen si masa paraprake janë:

- Paraprakisht, nisja e një fushate informimi të qytetarëve të cilët janë përfitues të kompensimit të VKM-ve në fuqi, me qëllim përfitimin e kompensimeve aktuale.
- Paraprakisht, shkëputja e përfitimit të kompensimeve të parashikuara nga VKM-të në fuqi nga koncepti i Kryefamiljarit.
- Paraprakisht, mosdiferencimi i llojit të aftësisë së kufizuar për përfitimin e kompensimeve të parashikuara në VKM-të në fuqi. Kompensimi të bëhet i mundur për të gjitha ato familje që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

- Përfshirja në përfitimin e kompensimeve të të gjitha familjeve të parashikuara në VKM- të, të cilat jetojnë në banesa me qira (pa kontratë noteriale) dhe që nuk rezultojnë abonentë të OSHEE.
- Paraprakisht, përfshirja e në përfitimin e kompensimit të të gjitha familjeve me të ardhura më të pakta se 35.000 Lekë në muaj dhe jo vetëm të punonjësve buxhetorë.
- Përfshirja në këto VKM me qëllim kompensimi edhe e të papunëve të regjistruar si punëkërkues papunë në zyrat e punësimit.

Në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, rekomandohet:

- ❖ Nxjerrja e aktit nënligjor që do të bëjë të mundur përcaktimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre;
- ❖ Në funksion të nxjerrjes së këtij akti duhet mbajtur parasysh që statusi i klientit në nevojë të ketë disa aspekte thelbësore të barabartë për të gjithë përfituesit, por dhe të vendosë disa kriterë elastikë për t’ju përshtatur më mirë veçantive të kategorive të ndryshme të përfshira;
- ❖ Si aspekt thelbësor i statusit të klientit në nevojë rekomandohet të jetë mosndërpreja e energjisë elektrike për arsye ekonomike (në funksion të kësaj Rregullorja e ERE është një pikënisje e mirë);
- ❖ Statusi i klientit në nevojë të parashikojë lehtësira për vendosjen e aparateve të energjisë elektrike, sidomos për familjet që kanë të ardhura më të vogla se paga minimale në shkallë kombëtare;
- ❖ Statusi i klientit në nevojë të parashikojë mundësinë e mbështjetjes totalisht nga shteti të pagesës deri në një nivel konsumi kWh për familjet me të ardhura më të pakta se paga minimale në shkallë kombëtare;
- ❖ Statusi i klientit në nevojë të parashikojë

mundësinë e shlyerjes totalisht të debisë energjitike nga ana e shtetit, për familjet me të ardhura më të pakta se paga minimale në shkallë kombëtare;

- ❖ Statusi i klientit në nevojë të parashikojë mundësinë e çmimit më të ulët për kWh për familjet që e përfitojnë këtë status;
- ❖ Si kriter për përcaktimin e statusit të klientit në nevojë, në mënyrë gjithëpërfshirëse, duhet të shërbejë gjendja ekonomike dhe përcaktimi i një niveli të ardhurash maksimal për përfitimin e statusit;

Në funksion të kësaj, si konsumatorë përfitues të statusit të klientit në nevojë rekomandohet të jenë:

- Familjet që kanë nivel të ardhurash më të vogël se tavani i të ardhurave i vendosur për përfitimin e statusit të klientit në nevojë;
- Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;
- Familjet që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuar sipas parashikimeve të të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”;
- Familjet që i mbështesin të ardhurat e tyre në përfitimin e të gjitha llojeve të pensioneve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- Familjet, burimi i të ardhurave të të cilave janë vetëm përfitimet e marra nga shteti;
- Familjet me dy Kryefamiljarë të papunë dhe të regjistruar si punëkërkues papunë;
- Familjet me një Kryefamiljar, që është i papunë dhe i regjistruar si punëkërkues papunë;

Së fundmi rekomandohet:

- Nisja e një fushate informuese të qytetarëve mbi energjinë elektrike, garantimit të saj, kategorive të përfshira në statusin e klientit në nevojë, procedurat për përfitimin.
- Informimi i qytetarëve në lidhje me

- eficencën e përdorimit të energjisë elektrike si dhe mbi rrezikun e përdorimit të mjeteve alternative si zjarri nëpërmjet drurit, gazit dhe materialeve djegëse të ndryshme;
- Shikimi i mundësive për financime nga shteti për sigurimin e energjisë elektrike nëpërmjet energjisë së rinovueshme;
- Mbajtja e të dhënave të rregullta në formën e Regjistrit, nëpërmjet një sistemi të detajuar dhe me lehtësira në kërkim;
- Ushtrimi i kontroleve për abuzimet dhe abuzuesit;
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për komunikimin ndërinstitucional si dhe shkëmbimin dhe dërgimin e informacionit midis tyre;

7. Referenca

- Bouzarovski, S. (2014). 'Energy poverty in the European Union: landscapes of vulnerability: Energy poverty in the European Union'. Wiley Interdisciplinary Reviews: Energy and Environment 3: 276–289
- S. Bouzarovski and S. Petrova. (November 2015). A global perspective on domestic energy deprivation: Overcoming the energy poverty–fuel poverty binary'. *Energy Research & Social Science*, pp. 31–40.
- DECC (2013). Fuel Poverty: a Framework for Future Action. Department for Energy and Climate Change. July 2013. ISBN: 9780101867320. HMSO, London. https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data
- EC (2009). DIRECTIVE 2009/72/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 13 July 2009 concerning common rules for the internal market in electricity and repealing Directive 2003/54/EC EC (2009b). DIRECTIVE 2009/73/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 13 July 2009 concerning common rules for the internal market in natural gas and repealing Directive 2003/55/EC
- E-Control (2013). Energy Poverty in Austria. Energie-Control Austria. Vienna, Austria
- https://ec.europa.eu/energy/topics/energy-efficiency/targets-directive-and-rules/energy-efficiency-directive_en, Date Accessed: 15 December 2020
- https://ec.europa.eu/energy/topics/markets-and-consumers/market-legislation/third-energy-package_en
- https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/INSIGHT_E_Energy%20Poverty%20-%20Main%20Report_FINAL.pdf, Date accessed: 3 December 2020
- Insight_E (2016), www.insightenergy.org, Date accessed: 20 January 2021
- <https://eur-lex.europa.eu/>, Date Accessed: 10 December 2020
- www.ere.gov.al, Ligji nr.43/2015 Per sektorin e energjise elektrike
- Insight_E (2015): Energy poverty and vulnerable consumers in the energy sector across the EU: analysis of policies and measures.
- Listo, R. (pp. 9–18). Gender myths in energy poverty literature: A Critical

- Discourse Analysis'. *Energy Research & Social Science*, vol. 38, April 2018.
- Pye, S., Dobbins, A., Baffert, C., Brajković, J., Grgurev, I., Miglio, R., & Deane, P (2015). Energy poverty and vulnerable consumers in the energy sector across the EU: analysis of policies and measures. Published by INSIGHT_E.
 - Schweizer-Ries, P. (2009). Energy Poverty: Impact and Public Recognition in the United Kingdom, France, Germany, Italy and Poland. FinSH Project no. EIE/07/146/SI2.466277.
 - <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/LLOGARITJA%20E%20MINIMUMIT%20JETIK%20N%C3%8B%20SHQIP%C3%8BRI.pdf>
 - <https://www.empowermed.eu/wp-content/uploads/2020/09/Varferia-Energjitike.pdf>.
 - *WorldBank(2017)Biomass-BasedHeating in the Western Balkans*. (n.d.). Retrieved from: http://documents.worldbank.org/curated/en/135831542022333083/pdf/Biomass-Based_Heating-in-the-Western-Balkans-A-Roadmap-for-Sustainable-Development.pdf

8. Aneks

Pyetësi

Anketë mbi: Mbrojtja e përmirësuar e “Konsumatorëve në Nevojë” kundër diskriminimit përmes forcimit të zbatimit të kornizës përkatëse ligjore dhe rregullatore.

Nr i pyetësorit _____

Unë quhem _____ dhe punoj për Organizatën _____. Ky është një studim që zhvillohet nga disa organizatë në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga diskriminimi për tu njohur me mundësitë tuaja për të paguar energjinë elektrike dhe efektet që ka në jetën tuaj dhe të familjes suaj kufizimet në marrjen e këtij shërbimi apo mungesa totale e këtij shërbimi. Sot do të zhvillojmë së bashku një bisedë me synimin për të vlerësuar nevojat dhe sfidat me të cilat përballeni në këtë drejtim për të krijuar ide më të qarta mbi mundësitë e përmirësimit të situatës suaj në të ardhmen e afërt. Çdo përgjigje juaj, pavarësisht se si do jetë, vlen shumë për këtë studim ndaj do ju luteshim që të ishit të sinqertë duke ju garantuar se emri juaj nuk do të përmendet në raportin përfundimtar të këtyre të dhënave.

I. Të dhëna të përgjithshme

1. Gjinia

- Mashkull 1
Femër 2

2. Moshë

- Nën 18 vjeç 1
19-30 2
31-40 3
41-50 4
51-60 5
61-70 6
Mbi 71 Vjeç 7

3. Statusi martesor:

- Beqar 1
I martuar 2
I divorcuar 3
E Ve 4

4. Lloji i vendbanimit:

- Urban 1
Rural 2

5. Sa vite arsim keni? _____ (vite shkolle të përfunduara, shëno me numër)

6. Prej sa anëtarësh përbëhet familja juaj? _____ (specifiko numrin e anëtarëve)

7. Përsa i përket përkatësisë suaj etnike, ju jeni?

- Shqiptar 1
Rom 2
Egjiptian 3
Tjetër, specifiko _____ 4

8. Cila është puna juaj kryesore, apo burimi kryesor i të ardhurave? _____

(ju lutem specifikoni)

9. Nëse ju nuk punoni, ju lutem specifikoni arsyen.

- Pension 1
Student 2
I sëmurë, i pamundur për të punuar 3
Tjetër, specifiko _____ 4

10. Sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj?

- Më pak se 20.000 lekë 1
25.000 lekë 2
30.000 lekë 3
40.000 lekë 4
50.000 lekë 5
Më shumë se 50.000 lekë 6

II. Aksesit në shërbimin e energjisë elektrike

11. A keni aktualisht energji elektrike në shtëpinë tuaj?

1. Po (kalo te pyetja 13)
2. Jo (shko te pyetja 12)

12. Referuar tabelës më poshtë ju lutem na tregoni arsyet se përse nuk keni energji elektrike? Më është ndërprerë lidhja e energjisë sepse nuk kam paguar në tre muajt e fundit 1

Më është ndërprerë sepse nuk kemi mundësi të paguajmë këstin e radhës të debisë në bazë të aktmarrëveshjes 2

Tjetër _____ 3

13. A ju është ndërprerë ndonjëherë në të shkuarën energjia elektrike?

1. Po
2. Jo

14. Sa është koha që jeni detyruar të qëndroni pa energji elektrike?

- | | |
|----------------------|----------------------------|
| 1-2 javë | <input type="checkbox"/> 1 |
| 1 -2 muaj | <input type="checkbox"/> 2 |
| 3-4 muaj | <input type="checkbox"/> 3 |
| 5-6 muaj | <input type="checkbox"/> 4 |
| 6 muaj-deri në 1 vit | <input type="checkbox"/> 5 |
| Më shumë se 1 vit | <input type="checkbox"/> 6 |

III. Efektet sociale të mungesës së energjisë elektrike apo përdorimit të kufizuar

15. Ju lutem na tregoni problemet që po ju shkakton aktualisht apo ju ka shkakuar në të shkuarën ju dhe familjes suaj mungesa e energjisë elektrike?

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____
- 4 _____
- 5 _____

16. Keni pasur problem me mungesën e energjisë elektrike edhe gjatë periudhës së Pandemisë?

1. Po
2. Jo

17. Si ndikon në shëndetin tuaj mungesa e energjisë elektrike?

- | | |
|-----------------------|----------------------------|
| Jashtëzakonisht shume | <input type="checkbox"/> 1 |
| Shume | <input type="checkbox"/> 2 |
| Pak | <input type="checkbox"/> 3 |

18. Ju lutem vlerësoni me notë nga 1-5 ku 1 = aspak e rëndësishme dhe 5 = shumë e rëndësishme secilin prej problemeve që mund të shkaktohen prej mungesës së energjisë elektrike, të listuara në tabelën më poshtë?

1 Mos funksionimi i pajisjeve elektro-shtëpiake

2 Mungesa e higjenës në mungesë të ujit të ngrohtë, dhe efekti tek shëndeti juaj

3 Mungesa e televizorit për tu informuar

4 Vështirësitë e fëmijëve për të mësuar dhe për të bërë detyrat e shkollës

5 Pamundësia që fëmijët të argëtohen në mungesë të ndriçimit

6 Tjetër _____

19. A e përdorni në mënyrë të kufizuar energjinë elektrike në shtëpinë tuaj?

1. Po
2. Jo

20. Ju lutem listoni problemet apo kushtëzimet që shkakton në cilësinë e jetës së familjes suaj përdorimi i kufizuar i energjisë elektrike?

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____
- 4 _____
- 5 _____

21. Sa të diskriminuar ndjeheni në raport me qytetarët e tjerë që kanë më shumë mundësi se ju të paguajnë pagesën mujore të energjisë elektrike dhe të kenë më shumë sasi në kv-orë?

- | | |
|----------------------|----------------------------|
| Shumë i diskriminuar | <input type="checkbox"/> 1 |
| Disi i diskriminuar | <input type="checkbox"/> 2 |
| Pak i diskriminuar | <input type="checkbox"/> 3 |
| Aspak i diskriminuar | <input type="checkbox"/> 4 |

IV. Mbështetja e Institucioneve dhe shkalla e informacionit

22. A e përfitoni pagesën mujore prej 1200 lekësh të rimbursimit për energjinë elektrike?

1. Po (Kalo te pyetja 20)
2. Jo (shko te pyetja 19)

23. Ju lutem na tregoni se cila është arsyeja se përse nuk e përfitoni?

24. A keni informacion mbi ligje apo politika të posacme për mbrojtjen e qytetarëve që bëjnë pjesë në shtresat në nevojë në lidhje me përfitimin e shërbimit të energjisë elektrike dhe a ju kane bere pjese institucionet per cdo vendimmarrje ne lidhje me energjine elektrike?

1. Po
2. Jo

25. A jeni ankuar apo keni kërkuar ndihmë në ndonjë institucion apo organizatë për të zgjidhur problemin që keni patur me ndërprerjen e energjisë elektrike apo pamundësisë për të paguar këstet mujore?

1. Po (shko te pyetja 26)
2. Jo (kalo te pyetja 27)

26. Ju lutem na tregoni se ku jeni drejtuar dhe cila ka qenë përgjigja që keni marrë?

27. Mbështetur në tabelën më poshtë, cilat mendoni se janë institucionet apo aktorët që mund tju ndihmonin dhe te të cilat do drejtoheshit për të zgjidhur ndonjë problem në lidhje me energjinë elektrike në të ardhmen?

- | | |
|--|----------------------------|
| Organizatata jo fitimprurëse | <input type="checkbox"/> 1 |
| Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi | <input type="checkbox"/> 2 |
| Bashkia | <input type="checkbox"/> 3 |
| Kryeministri | <input type="checkbox"/> 4 |
| Deputeti i zonës | <input type="checkbox"/> 5 |
| Tjetër _____ | <input type="checkbox"/> 6 |

28. Cila mendoni se do të ishte mbështetja më e mirë që mund të ofronte shteti për familjen tuaj në mënyrë që të arrini të paguani energjinë elektrike dhe të keni një sasi të pranueshme të energjisë elektrike në një muaj?

V. Efektet ekonomike të mungesës së energjisë elektrike apo përdorimit të kufizuar

29. Cilat janë njësitet e konsumit për nevojat e juaja familjare

- | | |
|---------|----------------------------|
| Ngrohje | <input type="checkbox"/> 1 |
| Gatim | <input type="checkbox"/> 2 |
| Ndriçim | <input type="checkbox"/> 3 |
| Tjetër | <input type="checkbox"/> 4 |

30. Cilat janë mënyrat e ngrohjes se ujit?

- | | |
|-------------------|----------------------------|
| Gas | <input type="checkbox"/> 1 |
| Dru | <input type="checkbox"/> 2 |
| Energji elektrike | <input type="checkbox"/> 3 |
| Tjetër | <input type="checkbox"/> 4 |

31. Me çfarë ngrohni në shtëpinë tuaj?

- | | |
|-------------------|----------------------------|
| Dru | <input type="checkbox"/> 1 |
| Gas | <input type="checkbox"/> 2 |
| Energji Elektrike | <input type="checkbox"/> 3 |

32. Sa përqind të të ardhurave të familjes suaj shkon për pagesën mujore të energjisë elektrike?

- | | |
|-----------------|----------------------------|
| 10% | <input type="checkbox"/> 1 |
| 20-30% | <input type="checkbox"/> 2 |
| 31-40% | <input type="checkbox"/> 3 |
| 40-50% | <input type="checkbox"/> 4 |
| Më shumë se 50% | <input type="checkbox"/> 5 |

33. A e dini sa është çmimi i energjisë elektrike?

- PO (kalo tek pyetja 34)
- JO

- 34.** Cili është mendimi juaj për çmimin e energjisë elektrike?
I lartë 1
Mesatar 2
I ulët 3
Skam mendim 4
- 35.** Ne cilat kategori përfituese të shtresave në nevojë të subvencionit bëni pjesë?
 1 Pensionistë
 2 Ndihmë Ekonomike
 3 Invalidë pune
 4 Të verbër
 5 Para-Tetraplegjikë
 6 Me aftësi tjera kufizuese
 7 Buxhetorë
 8 Pagesë Papunësie
- 36.** Sa te informuar jeni mbi legjislacionin mbi kushtet specifike për ndërprerjen me energji elektrike të klientëve në nevojë si dhe për përcaktimin e çmimit.
Shumë 1
Pak 2
Skam informacion 3
- 37.** A ekziston një skemë specifike mbështetëse për klientët në nevojë brenda sektorit të energjisë?
1. Po
2. Jo
- 38.** A i mbron sistemi i përgjithshëm i mirëqenies sociale klientët vunerabel në lidhje me energjinë?
1. Po
2. Jo
- 39.** Cilat kategori të klientëve marrin mbështetjen ekonomike brenda sektorit të energjisë?
- 39.** Nga se përbëhet sistemi i mbështetjes ekonomike brenda sektorit të energjisë?
- 40.** Si mbulohen shpenzimet e ofrimit të mbështetjes ekonomike për klientët në nevojë?
- 41.** Sa është përqindja e familjeve që kualifikohen që marrin ndihmë ekonomike
- 42.** Mbështetja jo-ekonomike brenda sektorit të energjisë, që zakonisht i referohet mbrojtjes kundër ndërprerjes së energjisë, në shumicën e rasteve ofrohet për klientët me gjendje të dobët shëndetësore, por edhe për disa kategori të tjera.
- 43.** A është skema e ndihmës për klientët vunerabel sezonale?
1. Po
2. Jo
- 44.** A është bazuar në një prag sasie skema e ndihmës ekonomike për klientët në nevojë?
1. Po
2. Jo

VI. Skemat mbështetëse për mbrojtjen e klientëve në nevojë

- 37.** A ekziston një skemë specifike mbështetëse për klientët në nevojë brenda sektorit të energjisë?
1. Po
2. Jo
- 38.** A i mbron sistemi i përgjithshëm i mirëqenies sociale klientët vunerabel në lidhje me energjinë?
1. Po
2. Jo
- 39.** Cilat kategori të klientëve marrin mbështetjen ekonomike brenda sektorit të energjisë?
- 39.** Nga se përbëhet sistemi i mbështetjes ekonomike brenda sektorit të energjisë?
- 40.** Si mbulohen shpenzimet e ofrimit të

